

**VËLLIMI XXV /PRILL-QESHOR/ 2024**

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2024**

**BULETINI ZYRTAR**



## PËRMBAJTJA

Nr.1071, Datë 19.04.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 970, DATË 24.03.2023, “MBI VLERËSIMIN LIGJOR TË AKT MARRËVESHJES NR. 2729 PROT.,DATË 13.02.2023, TË LIDHUR NDËRMJET DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, SHOQATËS “ KOMBËTARE TË AUTOSHKOLLAVE, SHOQATËS SË AUTOSHKOLLAVE “SIGURIA NË RRUGË” DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE””

Nr.1072, Datë 19.04.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SHA”

Nr.1073, Datë 19.04.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE NEOEN RENEWABLES CROATIA D.O.O. DHE FAZAN SOL D.O.O. NGA SHOQËRIA STATKRAFT OIE D.O.O.”

Nr.1074, Datë 26.04.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË RESITY TECHNOLOGIES D.O.O. NGA SHOQËRITË MESSER SE & CO. KGAA DHE DELTA HOLDING DOO BEOGRAD”

Nr.1075, Datë 26.04.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR RASTIN E KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, SHOQËRITË GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA DHE ALB-STAR SHPK, SI DHE TRANSAKSIONIN E SHITJES SË KUOTAVE TË SHOQËRISË ALB-STAR SHPK TEK SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA”

Nr.1076, Datë 10.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË OFFICINE MACCAFERRI - S.P.A. NGA SHOQËRIA AMBIENTA SGR SPA NËPËRMJET SHOQËRISË HOLDCO 69 S.R.L.”

Nr.1077, Datë 10.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI I MARRËVESHJES SË

LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE SWIXX BIOPHARMA AG DHE SANOFI WINTHROP INDUSTRIE”

Nr.1078, Datë 10.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT QË KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË

Nr.1079 Datë 24.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SHA”

Nr.1080, Datë 24.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË TËRTHORTË TË ASETVE NË PRONËSI TË KOMERCIJALNA BANKA AD NGA SHOQËRIA YILDIRIM INTERNATIONAL INVESTMENT HOLDING B.V.”

Nr.1081, Datë 24.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI PEZULLIMIN E AFATEVE TË PROCEDURËS SË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR TRANSAKSIONIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA SHOQËRITË MED LAB SHPK, EVITA SHPK DHE FARMACOM SHPK DHE FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONTROLLIT PËR TRANSAKSIONET E PA NJOFTUARA”

Nr.1082, Datë 06.06.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR RASTIN E KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ECO CLEANING SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, SHOQËRITË ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUCION SHPK DHE 2 T SHPK”

Nr.1083, Datë 06.06.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK DHE NDËRMARRJES AUTO HOLIDAY ALBANIA SHPK NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)”

Nr.1084, Datë 10.05.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR. 921, DATË 09.11.2022 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN STAR PARKING ALBANIA

SHPK”

Nr.1085 Datë 14.06.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NE QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER DHE KORCË”

Nr.1087, Datë 14.06.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK PËR REFUZIMIN E PRANIMIT TË INSPEKTIMEVE NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS”

Nr.1088, Datë 21.06.2024 .....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË DREJTPËRDREJTË TË SHOQËRISË ANCALA TOPCO LIMITED DHE INDIREKT PËRFTIMIT TË 50% TË KAPITALIT AKSIONAR TË SHOQËRISË DRAGON LNG LIMITED, NGA SHOQËRIA VTTI ENERGY UK LTD.”

Nr.1089, Datë 21.06.2024

.....**Error! Bookmark not defined.**

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”

**VENDIM**

**Nr. 1071, Datë 19. 04. 2024**

**“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 970, DATË 24.03.2023, “MBI VLERËSIMIN LIGJOR TË AKT MARRËVESHJES NR. 2729 PROT.,DATË 13.02.2023, TË LIDHUR NDËRMJET DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, SHOQATËS “KOMBËTARE TË AUTOSHKOLLAVE, SHOQATËS SË AUTOSHKOLLAVE “SIGURIA NË RRUGË” DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19. 04 .2024 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi monitorimin e zbatimit të VKK nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”,

## VËREN SE :

### I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës “Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” (në vijim VKK nr. 970/2023), ka vendosur:
  - I. *Akt Marrëveshja nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, e lidhur ndërmjet palëve: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave”, Shoqata e Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vlerësohet si një akt marrëveshje në kundërshtim me nenin 4 të ligjit 9121.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.*
  - II. *Monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.*
  - III. *Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të rëndë të konkurrencës në kuptim të nenit 74, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 9121/2003.*
2. VKK nr. 970/2023 i është komunikuar DPSHTRR-së, DPT-së, Shoqatës “Kombëtare të autoshkollave” dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”, me anë të shkresës së AK nr. 147/8 prot., datë 27.03.2023, me lëndë “Dërgim vendimi”.
3. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe pikës II të VKK nr. 970/2023, ka nisur procedurat për monitorimin e tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtitimit, dëshmisë ose çertifikatës, për një periudhë 1 (një) vjeçare.
4. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me monitorimin, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si dhe janë realizuar monitorime në terren pranë subjekteve Autoshkolla.
5. Në vijim të monitorimit, më datë 19.03.2024 janë zhvilluar takime me përfaqësues të Shoqatës “Kombëtare të autoshkollave” dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”. Gjatë takimeve u mbajtën procesverbalet përkatëse për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e monitorimit.

### II. Rregullimi ligjor

6. Autoshkollat funksionojnë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas rregullave dhe detyrimeve të

përcaktuara me akte nënligjore nga ministri përgjegjës për transportin rrugor. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën mbikëqyrjen administrative dhe teknike të veprimtarisë së autoshkollave, bazuar në aktet e nxjerra nga ministria që mbulon veprimtarinë.

7. Në mbështetje të neneve 119, 120 dhe 121, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe neneve 310, 311 dhe 313, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar udhëzimin nr. 9, datë 14.4.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”, i cili ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e autoshkollave si subjekte të përgatitjes së drejtuesve të mjeteve, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe kualifikimin e specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, pajisjen me certifikata dhe dëshmi të aftësisë profesionale, rifitimin e lejes së drejtimit nga humbja e plotë e pikëve.
8. Tarifat për shërbimet që DPSHTRR ofron në sektorin e lejeve të drejtimit, në zbatim të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, miratohen nga ministri përgjegjës për transportin rrugor, të cilat së fundmi janë ndryshuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 41, datë 22.12.2023, “Për miratimin paraprak të tarifave të lejedrejtitimit dhe tarifave të certifikatës së aftësisë profesionale”, vendim i cili është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6/1 prot., datë 16.01.2024, “Mbi miratimin e vendimit nr. 41, datë 22.12.2023 të Këshillit Drejtues”.

### III. Rezultatet e monitorimit

9. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të VKK nr. 970/2023, ka monitoruar subjektet Autoshkolla të cilat ofrojnë shërbimin e mësimit teorik dhe trajnimit praktik për paisjen me leje drejtimi, në lidhje me çmimet e ofrimit të këtyre shërbimeve gjatë periudhës 1 (një) vjeçare të monitorimit. Për qëllime të monitorimit është përdorur metodologjia *secret shopper*<sup>1</sup>, si një instrument për tu informuar në lidhje me paketat e çmimeve të shërbimeve të ofruara nga autoshkollat.
10. Nga monitorimi në terren i rreth 45 subjekteve Autoshkolla, nëpër qarqe të ndryshme të Shqipërisë, të cilat ofrojnë shërbimin e mësimit teorik dhe trajnimit praktik për paisjen me leje drejtimi (kategoria B), rezultoi se në lidhje me çmimet e ofrimit të këtyre shërbimeve ato variojnë nga 23.000 lekë deri në 45.000 lekë. Kryesisht subjektet Autoshkolla që ndodhen në qarkun e Tiranës ofrojnë çmime më të larta se subjektet Autoshkolla të qarqeve të tjera në vend. Disa nga faktorët që sjellin diferenca midis çmimeve të paketave të shërbimeve të ofruara nga autoshkollat, kanë

---

<sup>1</sup> Secret Shopper, është një formë e hulumtimit të tregut që përfshin punësimin ose trajnimin e njerëzve për të vepruar si klientë dhe për të vizituar, telefonuar ose ndërvepruar me ndërmarrjet. Ata ndjekin një skenar dhe kriteret specifike për të vlerësuar aspekte të ndryshme të ndërmarrjeve, të tilla si veçoritë e produktit, çmimi, cilësia e shërbimit, sjellja e stafit, dhe aktivitetet promovuese.

rezultuar: numri i orëve mësimore; kostot e ndryshme; materialet mësimore etj.

11. Nga monitorimi i subjekteve autoshkolla rezulton se, gjatë periudhës së monitorimit (mars 2023 – mars 2024), nuk vërehen ndryshime të çmimeve të shërbimit të mësimit teorik dhe trajnimit praktik për pajisjen me leje drejtimi (kategoria B), si dhe për pajisjen me leje drejtimi për kategoritë e tjera.
12. Gjithashtu edhe nga takimet e zhvilluara më datë 19.03.2024 me përfaqësues të Shoqatës “Kombëtare e Autoshkollave” dhe Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë”, rezultoi se, gjatë periudhës 1 (një) vjecare nën monitorim, çmimi i shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi të ofruara nga subjektet autoshkolla nuk ka pësuar rritje.
13. Gjatë periudhës së monitorimit Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 41, datë 22.12.2023, “Për miratimin paraprak të tarifave të lejedrejtimit dhe tarifave të çertifikatës së aftësisë profesionale”, ka miratuar paraprakisht tarifat e reja të shërbimeve të lejedrejtimit dhe shërbimeve të certifikatës së aftësisë profesionale. Ky vendim është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 6/1 prot., datë 16.01.2024, “Mbi miratimin e vendimit nr. 41, datë 22.12.2023 të Këshillit Drejtues”.
14. Rishikimi i tarifave të shërbimeve të drejtuesve të mjetit, sipas DPSHTRR, është bërë bazuar në përlllogaritjen e analizës së kostos, pas 23 vitesh. Një pjesë e tarifave nuk ishin rishikuar që nga viti 2001 dhe pjesa më e konsiderueshme e tyre kanë qenë të pandryshuara prej 15 vitesh, pavarësisht rritjeve të kostove operative dhe rritjes së kostove në sistemet informatike për informatizimin e shërbimeve. Gjithashtu në vijim të ndryshimeve të fundit të Kodit Rrugor, neni 124, është zgjatuar në 15 vjet afati i vlefshmërisë së lejedrejtimit për personat deri në moshën 70 vjeç.
15. Sa më sipër, në përfundim të procedurës së monitorimit të tregut të shërbimit të përgatitjes dhe pajisjes me leje drejtimi, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose çertifikatës, në zbatim të VKK nr. 970/2023, rezulton se, nga ana e subjekteve Autoshkolla është zbatuar pika I e VKK nr. 970/2023, duke mos aplikuar rritjen e tarifave sipas Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, e cila është vlerësuar si një akt marrëveshje në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit të zbatimit të VKK nr. nr. 970, datë 24.03.2023, “Mbi vlerësimin ligjor të Akt Marrëveshjes nr. 2729 prot., datë 13.02.2023, të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Shoqatës



“Kombëtare të Autoshkollave”, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”.

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1072, Datë 19. 04. 2024**

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19. 04. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA

**VËREN SE:**

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 96/6 prot., datë 18.03.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 48 prot., datë 10.11.2023, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier

SHA më datë 08.09.2022, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Tarifat e miratuara janë sipas vendimit të KKRR nr. 142, datë 27.11.2020 për Bashkinë Fier, Vendimin e KKRR nr. 53, datë 04.02.2021 për Bashkinë Patos, Vendimin e KKRR nr. 69, datë 30.12.2019 për Bashkinë Roskovec dhe Vendimin e KKRR nr. 26, datë 17.01.2022 për Bashkinë Mallakastër. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2024; 2025 dhe 2026, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes
5. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i ndërmarrjes për vitin 2024, 2025 dhe 2026. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese. Pas riorganizimit të sektorit është themeluar ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA për të cilën po miratohen tarifa të unifikuara.
6. Ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SHA propozon tarifat e reja si rezultat i nevojës për përmirësim të performancës financiare dhe mbulimin e kostove operacionale; për shkak të rritje së çmimeve të materialeve; reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele të larta; përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; realizimi i të ardhurave për përballimin e kostove shtesë.

7. Ndërmarrja rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA ka kërkuar ndryshimin e tarifave, për vendosjen në një nivel të ri katër vitesh Bashkia Fier dhe Bashkia Roskovec dhe pas dy vitesh Bashkia Mallakastër. Bashkia Patos nuk ka aplikuar për nivel të ri tarifash sepse i ka pasur të larta tarifat dhe këto tarifa janë unifikuar edhe për Bashkitë e tjera në lidhje me ofrimin e shërbimit të FU dhe KUN si edhe duke vlerësuar analizën e kostove për ofrimin e këtyre shërbimeve që parashikohet të shtrihet deri në vitin 2026.
8. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021 lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2024; vitin 2025 dhe vitin 2026 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 63 % për vitin 2022 me një rritje 105 % për në fund të vitit 2026. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 57.4% në fund të vitit 2026 kundrejt 35.6% në vitin 2022.
10. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA duhet të instaloj matëset në burim (Bulk metër), si edhe matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes; të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet; të organizojë taks- forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Fier, Patos, Mallakastër, Roskovec për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale; të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura; të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2023, vitin 2024 e në vazhdim; të gjejnë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit, i cili shkakton humbje fizike në nivele të lartë; të mbaj nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimeve të defekteve, për të minimizuar sa me shumë humbjet nga rrjedhjet; të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për

të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet; Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2024;

11. Në aspektin ekonomik, ERRU gjykon se ndërmarrja rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA duhet të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim, që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimit të parashikuar për t'u realizuar në vitin 2024; të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si; monitorimi i klientëve, ndërprerja e shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesat bankare apo pagesa online; të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri; të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m<sup>3</sup> ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë,
- Të hartojë një data basë me të gjithë konsumin e energjisë (bazuar tek matësit, faturat e energjisë etj.) duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos,
- Të krahasoj dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim,
- Të realizojë trajnime për efikasitetin e energjisë për stafin operativ.

12. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura” ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njërive të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime” ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

13. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.
14. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:
- Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
  - Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjetës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
  - Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
  - Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
  - Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
15. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetës Kanalizimeve.

16. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
- a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
  - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Tirane SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
  - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
17. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA.
18. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifat variabël të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA, por jo në nivelet që propozon Ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr.539, datë 30.12.2021” Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës kanalizime” duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifat (kostot operationale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2022) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.
19. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021 përmban dhe aprovimin e prezantimit për në Seancën Dëgjimore me Publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Fier, Roskovec dhe Mallakastër, si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SHA, konstatojmë se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.

20. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).
21. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Fier, Roskovec dhe Mallakastër, si edhe në ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA seancat e zhvilluara të dëgjjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



**VENDIM**

**Nr.1073, Datë 19. 04. 2024**

**“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE NEOEN RENEWABLES CROATIA D.O.O. DHE FAZAN SOL D.O.O. NGA SHOQËRIA STATKRAFT OIE D.O.O.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19. 04. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o.,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përfimin e kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o..

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

**Pala blerëse: STATKRAFT OIE d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar

sipas legjislacionit kroat. Aktiviteti i shoqërisë kufizohet në projektimin dhe prodhimin e energjisë elektrike, konkretisht në: transmetim, organizim, tregtim, ruajtje, shpërndarje të energjisë elektrike; menaxhim i objekteve energjetike; projektim, ndërtim dhe mbikëqyrje e ekspertëve të ndërtimit; veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike etj.

STATKRAFT OIE d.o.o. zotërohet nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit norvegjez, pjesë e Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

*Statkraft Renewables Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre, si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

*Devoll Hydropower SHA* është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit, si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

#### **Pala shitëse:**

**1- NEOEN, Soci t  Anonyme (NEOEN SA)** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez, e angazhuar në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me energjinë dhe mjedisin, veçanërisht në sektorët e energjisë elektrike, gazit dhe ujit etj.

**2- NEOEN HOLDING CROATIA I** është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe në përputhje me legjislacionin francez, me objekt aktiviteti mbajtjen e të gjitha interesave dhe pjesëmarrjeve në fondet e kapitalit neto, duke përfshirë pronësinë e plotë të kapitalit të një ose më shumë shoqërive, civile, tregtare, industriale, financiare ose të tjera, franceze ose të huaja, të krijuara ose që do të krijohen me çdo mjet dhe në çdo formë.

Shoqëria zotërohet indirekt nga shoqëria NEOEN SA.

#### **Shoqëritë Target:**

**1- Neoen Renewables Croatia d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit të Kroacisë. Referuar ekstraktit të shoqërisë, objekti i saj i aktivitetit është: menaxhimi i projekteve të ndërtimit, veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike; kryerja e investimeve jashtë vendit dhe dhënia e këtyre punimeve investuese personave të huaj në Republikën e Kroacisë; prodhim, transmetim, ruajtje, menaxhim, furnizim, tregtim i energjisë elektrike; prodhim i pajisjeve për shpërndarjen dhe kontrollin e energjisë elektrike; projektim, prodhim, montim dhe mirëmbajtje e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, objekteve

industriale etj.

Shoqëria target zotërohet nga NEOEN SA dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

**2- Fazan Sol d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit të Kroacisë. Referuar ekstraktit të shoqërisë, objekt i saj i aktivitetit është: menaxhimi i projekteve të ndërtimit, veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike; prodhim, transmetim, ruajtje, menaxhim, furnizim, tregtim i energjisë elektrike; prodhim i pajisjeve për shpërndarjen dhe kontrollin e energjisë elektrike; projektim, prodhim, montim dhe mirëmbajtje e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, objekteve industriale etj.

Shoqëria target zotërohet nga NEOEN HOLDING CROATIA I dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

## **II. Përqendrimi**

Ndërmjet shoqërisë STATKRAFT OIE d.o.o. (blerësi), shoqërisë NEOEN, Société Anonyme dhe shoqërisë NEOEN HOLDING CROATIA I (shitësit) është lidhur “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, në lidhje me aksionet e shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o., e nënshkruar më datë 21 mars 2024.

Referuar kësaj marrëveshje, Shitësit shesin Aksionet në Shitje Blerësit dhe Blerësi pranon dhe blen Kuotat në shitje nga Shitësit, në përputhje me parashikimet dhe kushtet e specifikuar në këtë Marrëveshje.

Duke qënë se kontrolli i shoqërive target, aktiviteti, pronarët e fundit përfitues, bordi i administrimit dhe operacionet e biznesit janë të ndërthurura (NEOEN HOLDING CROATIA I kontrollohet indirekt nga NEOEN SA), transaksioni parashikohet si një marrëveshje paketë.

Blerësi do të përftojë kontrollin e plotë të shoqërive target, pas përmbushjes së kushteve paraprake të përcaktuara në marrëveshje.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **III. Analiza e Konkurrencës**

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe ruajtjes së energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, por duke qënë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përftimi i kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o.

STATKRAFT OIE d.o.o. është pjesë e Grupit Statkraft, i cili është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme. Gjatë vitit 2022, prodhimi total i energjisë elektrike, në vend, nga hidrocentralet është 6,952,553 MWh dhe dy hidrocentralet e Devolli Hydropower kanë prodhuar 490,421 MWh energji ose rreth 7% e prodhimit.

Shoqëritë target, Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. janë të angazhuara në projekte të prodhimit të energjisë elektrike nga burime diellore dhe të erës, si dhe në projektin e ruajtjes së energjisë së baterive, në Kroaci. Shoqëritë target nuk janë prezent dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Blerësi dhe shoqëritë target janë aktivë në tregun e zhvillimit të projekteve të energjisë nga burime të rinovueshme, por vetëm blerësi ka aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria STATKRAFT OIE d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1074 , Datë 26. 04. 2024**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË RESITY TECHNOLOGIES D.O.O. NGA SHOQËRITË MESSER SE & CO. KGAA DHE DELTA HOLDING DOO BEOGRAD”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 04. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit lidhur me përfitimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; “Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të propozuar mbi përfitimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfitimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. nga shoqëritë Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

**Pala blerëse:** Messer SE & Co. KGaA (Messer), një shoqëri komandite, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e: gazeve të të gjitha llojeve; makinerive, impianteve, pajisjeve dhe materialeve ndihmëse, veçanërisht për prodhimin, lëngëzimin, ndarjen dhe pastrimin e gazeve dhe përzierjeve të gazit, si dhe ruajtjen, tregtimin, matjen, testimin, kontrollin dhe aplikimin e gazeve; gazeve mjekësore dhe pajisjeve laboratorike etj.

Messer kontrollohet tërësisht nga shoqëria Messer Holding GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë dhe menaxhohet nga *aksionari me përgjegjësi individuale* Messer Management SE, i cili siguron burimet e nevojshme dhe personelin për menaxhimin e shoqërisë.

Messer është pjesë e Messer Group, i cili është i pranishëm në Shqipëri përmes shoqërisë së kontrolluar indirekt prej saj, Messer Albagaz SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjisllacionit shqiptar, me aktivitet të saj: prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e gazrave industrial, mjekësor dhe special, si dhe të pajisjeve që lidhen me to; ofrimin e shërbimeve të inxhinierisë (Engineering), si dhe tregtimin e materialeve dhe ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet e prerjes dhe saldimit dhe me teknologjinë e veshjes apo shkrirjes, si edhe kryerjen e transportit të mallrave për nevojat e veta dhe të të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Pala shitëse: DELTA HOLDING DOO BEOGRAD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, aktivitetet kryesore të regjistruara të të cilës janë kontabiliteti, mbajtja e bilanceve financiare, auditimi dhe konsulenca tatimore.

DELTA HOLDING DOO BEOGRAD është shoqëria mëmë e Grupit të shoqërive Delta Holding.

DELTA HOLDING DOO BEOGRAD zotëron shumicën e kuotave dhe ushtron kontrollin e shoqërisë target RESITY TECHNOLOGIES d.o.o.

**Shoqëria Target: RESITY TECHNOLOGIES d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Serbisë, aktive në fushën e shërbimeve të konsulencës profesionale SAP (sistemet, aplikacionet dhe produktet). Shoqëria ofron produkte për klientët dhe partnerët, duke i mbështetur ata me ekspertë dhe konsulentë të rinj të SAP, të përshtatur për nevojat e tyre.

Shoqëria target zotërohet nga DELTA HOLDING DOO BEOGRAD, z. ŽELJKO ŠTIMAC, znj. ANKICA BOŽIĆ SUPANC dhe znj. ALMA TASIĆ (ortakët e pakicës).

## II. Përqendrimi

Më datë 20 nëntor 2023, ndërmjet palëve Messer SE & Co. KGaA (blerësi) dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD (shitësi) është nënshkruar “Marrëveshje për blerjen e kuotave”.

Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje, gjatë transferimit, blerësi pranon të blejë nga shitësi dhe shitësi pranon të shesë, dorëzojë, transferojë dhe t’ia kalojë blerësit, të

drejtën e plotë të pronësisë mbi Kuotat e Shitjes, të lira nga çdo barrë dhe së bashku me të gjitha të drejtat e bashkangjitura sipas ligjit në fuqi.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target RESITY TECHNOLOGIES d.o.o.do të zotërohet 61.40% nga DELTA HOLDING DOO BEOGRAD, 25.10% nga Messer SE & Co. KGaA, 7.5% nga z. ŽELJKO ŠTIMAC, 3% nga znj. ANKICA BOŽIĆ SUPANC dhe 3% nga znj. ALMA TASIĆ.

Blerësi Messer SE & Co. KGaA, shitësi DELTA HOLDING DOO BEOGRAD dhe ortakët e pakicës do të miratojnë një akt të ri (statut) të shoqërisë target RESITY TECHNOLOGIES d.o.o., i cili zëvendëson plotësisht statutin aktual të shoqërisë target.

Referuar Draft - Aktit të ri të Themelimit, organet e shoqërisë target RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. janë: Asambleja e shoqërisë dhe Drejtori i shoqërisë. Shoqëria do të ketë dhe një Bord Këshillimor, i cili ofron mbështetje profesionale për Drejtorin e shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së shoqërisë, për çështjet e: ndryshimit në Aktin e Themelimit; miratimin e buxhetit vjetor të shoqërisë; përcaktimin e strategjisë së biznesit dhe investimit dhe objektivave të biznesit etj, kërkojnë pëlqimin e DELTA HOLDING DOO BEOGRAD dhe Messer SE & Co. KGaA.

Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 3.2 është përcaktuar se: “Kontrolli i përbashkët mund të ekzistojë edhe kur nuk ka barazi ndërmjet dy ndërmarrjeve mëmë për sa i përket votave ose në përfaqësimin në organet vendimmarrëse. Ky është rasti kur aksionarët në pakicë kanë të drejta shtesë, të cilat u lejojnë atyre të marrin vendime vetoje, të cilat janë thelbësore për sjelljen strategjike tregtare të sipërmarrjes së përbashkët/joint venture. Të drejtat e vetos në vetvete mund të ushtrohen nëpërmjet mjeteve të një kuorumi të caktuar, të kërkuar për vendimet që merren në mbledhjen e aksionareve ose nga bordet e drejtorëve në masën që ndërmarrjet mëmë janë përfaqësuar në këtë bord.”

Për sa më sipër, kontrolli i shoqërisë target do të ushtrohet bashkërisht nga Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD dhe transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kapitullit II (pjesa 3.2) të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimeve IT, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. nga shoqëria Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO

BEOGRAD.

Shoqëria RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. ka prani shumë të kufizuar në tregun përkatës në Shqipëri.

Shoqëria Messer SE & Co. KGaA është pjesë e Grupit Messer, i cili është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet Messer Albagaz SHPK, i cili është aktiv në prodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e gazeve industriale, mjekësore dhe të specializuara.

DELTA HOLDING DOO BEOGRAD nuk zotëron asnjë filial që operon në tregun e IT-së. Ajo ka një departament të brendshëm të IT-së, i cili shërben si një mbështetje e brendshme për Delta Holding Group.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat dhe nuk do të sjellë ndryshime të strukturës së tregut në Shqipëri, pasi Messer dhe RESITY nuk janë prezente në të njëjtin treg përkatës të produktit.

Pjesa e tregut e shoqërisë Messer Albagaz do të mbetet e pandryshuar edhe pas përqendrimit dhe përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin lidhur me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë RESITY TECHNOLOGIES d.o.o. nga shoqëria Messer SE & Co. KGaA dhe DELTA HOLDING DOO BEOGRAD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**



**VENDIM**

**Nr. 1075 , Datë 26. 04. 2024**

**“MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR RASTIN E KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, GRABOVA HYDROPOWER SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, SHOQËRITË GR ALBANIA SHPK, AGNA SHA DHE ALB-STAR SHPK, SI DHE TRANSAKSIONIN E SHITJES SË KUOTAVE TË SHOQËRISË ALB-STAR SHPK TEK SHOQËRIA GJOKA KONSTRUKSION SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26. 04. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për fillimin të procedurave të kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të shoqërisë Grabova Hydropower SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR Albania SHPK, shoqëria Agna SHA dhe shoqëria Alb-Star SHPK, si dhe shitjen e kuotave të shoqërisë Alb-Star SHPK tek shoqëria Gjoka Konstruksion SHA.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, neni 29/1, neni 59 dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të shoqërisë Grabova Hydropower SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR Albania SHPK, shoqëria Agna SHA dhe shoqëria Alb-Star SHPK, si dhe shitjen e kuotave të shoqërisë Alb-Star SHPK tek shoqëria Gjoka Konstruksion SHA.,

**VËREN SE :**

## **I. Procedura**

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 232 prot.i AK, datë 12.03.2024 “Kërkesë për Informacion” u njoftua nga një media televizive, mbi rastin e krijimit të shoqërisë Grabova Hidropower SHPK, nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR Albania SHPK, shoqëria Agna SHA dhe shoqëria Alb-Star SHPK, si dhe transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë Alb-Star SHPK tek shoqëria Gjoka Konstruksion SHA.

Me shkresën nr. 232/1 prot., datë 21.03.2024, “Kërkesë për informacion”, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacionin nga shoqëria Grabova Hydropower SHPK, për vlerësimin e kushteve të përcaktuara në nenet 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 232/3 prot., datë 11.04.2024, “KTHIM PËRGJIGJE”, shoqëria Grabova Hydropower SHPK ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

## **II. Transaksioni**

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë evidentuar dy transaksione:

### *II.1 Transaksioni i parë.*

Më datë 20.09.2017, shoqëritë GR Albania SHPK, Agna SHA dhe Alb-Star SHPK kanë themeluar një ndërmarrje të përbashkët, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Grabova Hydropower SHPK, ku GR Albania SHPK zotëron 33%, Agna SHA zotëron 33% dhe Alb-Star SHPK zotëron 34% të kuotave.

*Palët në transaksion:*

- 1. GR Albania SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar.
- 2. Agna SHA**, shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar.
- 3. Alb-Star SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar.

**Ndërmarrja e Përbashkët - Grabova Hydropower SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar.

Shoqëria ka si objekt të aktivitetit, ndërtimin e hidrocentralit mbi Lumin Grabovë, të tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero); prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-i mbi Lumin Grabovë, shfrytëzimi dhe-mirëmbajtja e kaskadës si më sipër gjatë periudhës konçesionare.

### *II.2 Transaksioni i dytë.*

Më datë 05.04.2021, shoqëritë Alb-Star SHPK (shitësi) dhe Gjoka Konstruksion SHA (blerësi) kanë lidhur kontratë shitblerje kuote, ku shoqëria Gjoka Konstruksion ka blerë kuotën që shoqëria

Alb-Star SHPK zotëron në shoqërinë Grabova Hydropower SHPK.

*Palët në transaksion:*

**Blerësi: Gjoka Konstruksion SHA**, shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar.

**Shitësi: Alb-Star SHPK.**

**Shoqëria target: Grabova Hydropower SHPK.**

Aktualisht shoqëria Grabova Hydropower SHPK zotërohet 33% nga GR Albania SHPK, 33% nga Agna SHA dhe 34% nga Gjoka Konstruksion SHA.

Referuar informacionit të depozituar, transaksioni i parë dhe transaksioni i dytë përbëjnë përqendrime në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit që kemi ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Grabova Hydropower SHPK.

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Rasti i krijimit të ndërmarrjes Grabova Hydropower SHPK nga shoqëritë Agna SHA, GR Albania SHPK dhe Alb-Star SHPK, si dhe transaksioni i shitjes së kuotave të shoqërisë Alb-Star SHPK tek shoqëria Gjoka Konstruksion SHA nuk janë njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi vëren shkelje në detyrimin për njoftim, fillon me nismën e vet procedurat për kontrollin e përqendrimeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët Grabova Hydropower SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria GR Albania SHPK, shoqëria Agra SHA dhe shoqëria Alb-Star SHPK.
2. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e shitjes së kuotave të shoqërisë Alb-Star SHPK tek shoqëria Gjoka Konstruksion SHA.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1076 , Datë 10. 05. 2024**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË OFFICINE MACCAFERRI - S.P.A. NGA SHOQËRIA AMBIENTA SGR SPA NËPËRMJET SHOQËRISË HOLDCO 69 S.R.L.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10. 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L.,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje” (lidhur me Officine Maccaferri - S.P.A.), nënshkruar më datë 10 shkurt 2024, palët në marrëveshje janë:

**Blerësi: HoldCo 69 S.R.L.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me aksionar të vetëm TopCo 69-Bis S.R.L. dhe me objekt aktiviteti: kryerja e veprimtarisë së marrjes, mbajtjes dhe administrimit të aksioneve dhe interesave në shoqëri italiane dhe të huaja, me qëllim investimin e qëndrueshëm, etj; ushtrimi për pjesën e mbetur dhe qëllime praktike në lidhje me aktivitetet e përmendura sa më lart, etj.

HoldCo 69 S.R.L. është një filial i zotëruar nga Ambienta SGR SPA, i krijuar për qëllim të realizimit të transaksionit të propozuar. Pas finalizimit të transaksionit të propozuar, kontrolli i target do të transferohet te Ambienta SGR SPA (nëpërmjet filialit të saj HoldCo 69 S.R.L.). Si rezultat i transaksionit të propozuar, target do të zotërohet në mënyrë të tërthortë 100% nga Ambienta SGR SPA.

**Ambienta SGR SPA (Ambienta Societa Gestion Del Risparmio Società Per Azioni)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë dhe me objekt aktiviteti: ofrimi i shërbimit të menaxhimit të kursimeve kolektive i arritur nëpërmjet promovimit, krijimit dhe organizimit të organizatave të investimit, etj. Portofoli i saj përfshin shoqëri që operojnë në sektorët e energjisë së rinovueshme, biokarburanteve, efikasitetit të energjisë, zbutjes së ndotjes dhe menaxhimit të burimeve të mbetjeve dhe ujit.

Ambienta SGR SPA nuk ka asnjë filial, por realizon xhiro në Republikën e Shqipërisë.

**Target: Officine Maccaferri - S.P.A.** është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Officine Maccaferri - S.P.A. së bashku me filialet e tij, të kontrolluara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, është i angazhuar në kërkimin, projektimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inovative për infrastrukturën, minierat, kontrollin e lumenjve dhe mbrojtjen e mjedisit. Targeti u ofron klientëve të tij shumëllojshmëri produktesh në një gamë të gjerë tregjesh që mund të klasifikohen në kategoritë: (i) Rrjetë me rrotullim të dyfishtë; (ii) Gjeosintetikë; (iii) Mbrojtja nga rënia e shkëmbinjve dhe strukturat e rrjetave të borës; (iv) Tunelizim; (v) Produkte të tjera.

Në Shqipëri shoqëria Officine Maccaferri - S.P.A. operon nëpërmjet filialit të saj **Maccaferri Balkans SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe tregtimin e produkteve me përdredhje të dyfishtë (si gabione, materase dhe rrjeta), i rrjetave në formë unazore dhe tregtimin e produkteve gjeosintetike të përdorura për të zgjidhur problemet në lidhje me kontrollin e erozionit, stabilizimin e terrenit, mbrojtjen nga rënia e gurëve, projekte infrastrukture në sektorë si rrugë, hekurudha, lumenj, kanale, landfille, mbrojtje bregdetare dhe ndërtime civile në territorin e Shqipërisë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe në çdo vend tjetër të përcaktuar nga Organi i Administrimit (“Territori”), etj.

Officine Maccaferri - S.P.A. zotërohet aktualisht 100% nga shoqëria **OM TopCo S.à r.l.**

**Shitësi: OM TopCo S.à r.l.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas

legjislacionit të Dukatit të Madh të Luksemburgut, e regjistruar në regjistrin tregtar dhe të shoqërive tregtare të Luksemburgut. Kapitali i shoqërisë OM TopCo S.à r.l. zotërohet plotësisht nga Grupi Ad-Hoc.

## **II. Përqendrimi**

Më datë 10 shkurt 2024, është nënshkruar “Marrëveshje shit-blerje”, ndërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L. në cilësinë e blerësit dhe shoqërisë OM TopCo S.à r.l. lidhur me shoqërinë target Officine Maccaferri - S.P.A.

Referuar kësaj Marrëveshje, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara, në datën e finalizimit shitësi do t’i shesë blerësit dhe blerësi do të blejë nga shitësi, të gjitha aksionet, të lira dhe të parënduara me barrë, kundrejt pagesës së çmimit të blerjes.

Shitësi ka rënë dakord të shesë tek filiali i zotëruar nga Ambienta SGR SPA, HoldCo 69 S.R.L., aksionet që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë target.

Pas finalizimit të transaksionit të propozuar, kontrolli i shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. do të transferohet tek shoqëria Ambienta SGR SPA (nëpërmjet filialit të saj HoldCo 69 S.R.L., duke përfutur tërthorazi kontrollin e shoqërisë target).

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **III. Analiza e konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për prodhimin dhe furnizimin e materialeve për inxhinierinë mjedisore, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L.

Shoqëria Ambienta SGR SPA është një fond privat kapitalesh, i specializuar në zmadhimin e investimeve me konsiderata mjedisore dhe qëndrueshmërie, në tregje private dhe publike. Për qëllime të këtij transaksioni, është krijuar shoqëria HoldCo 69 S.R.L. me objekt aktiviteti kryerjen e veprimtarisë së marrjes, mbajtjes dhe administrimit të aksioneve dhe interesave në shoqëri italiane dhe të huaja, me qëllim investimin e qëndrueshëm, etj.

Shoqëria Officine Maccaferri - S.P.A. është një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti studimin, projektimin, prodhimin dhe tregtimin e zgjidhjeve në fushën e inxhinierisë mjedisore dhe civile që synojnë stabilizimin dhe forcimin e tokave, kontrollin e gërryerjeve të tokës, etj. Ai është një ofrues

i zgjidhjeve të avancuara për tregjet e ndërtimit civil, gjeoteknik dhe mjedisor, me mbi 20 impiante në 4 kontinente.

Kjo shoqëri zotëron 100% Maccaferri Balkans SHPK, e cila është aktive në prodhimin dhe tregtimin e produkteve me përdredhje të dyfishtë (si gabione, materase dhe rrjeta), i rrjetave në formë unazore dhe tregtimi i produkteve gjeosintetike të përdorura për të zgjidhur problemet në lidhje me kontrollin e erozionit, stabilizimin e terrenit, mbrojtën nga rënia e gurëve, projekte infrastrukture në sektorë si rrugë, hekurudha, lumenj, kanale, landfille, mbrojtje bregdetare dhe ndërtime civile; import-export i produkteve me natyrë gjeoteknike, etj.

Ambienta SGR SPA nuk është e pranishme në tregjet ku targeti operon në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Officine Maccaferri - S.P.A. nga shoqëria Ambienta SGR SPA nëpërmjet shoqërisë HoldCo 69 S.R.L.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**



**VENDIM**

**Nr. 1077, Datë 10. 05. 2024**

**“PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI I MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE SWIXX BIOPHARMA AG DHE SANOFI WINTHROP INDUSTRIE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10. 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Shtyrja e afatit të përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI WINTHROP INDUSTRIE.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, lidhur me shtyrjen e afatit të përjashtimit nga ndalimi i marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI WINTHROP INDUSTRIE,

**VËREN SE:**

**I. Procedura e ndjekur.**

Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 905, datë 29.07.2022 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Swixx Biopharma AG dhe SANOFI-AVENTIS GROUPE”, ka vendosur:

1. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Distribucionit ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi;

Në pikën 4 të nenit 50 “Vendimi për përjashtime individuale”, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” parashikohet se: *Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.*

Nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, palët Swixx Biopharma AG dhe SANOFI WINTHROP INDUSTRIE, kanë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, kërkesën për zgjatjen e afatit të përjashtimit individual për “Marrëveshje Ekskluzive e Distribucionit”, e lidhur më datë 12.07.2021, e cila hynte në fuqi më datë 1 janar 2022, ndërmjet shoqërisë Swixx Biopharma AG dhe Sanofi-Aventis Groupe.

## **II. Palët në marrëveshje**

**Swixx Biopharma AG (Distributori)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kantonit Zug, Zvicër, me objekt aktiviteti: tregtimi, konsulenca dhe ofrimi i përfaqësive në sektorin e shëndetësisë, mbështetja ndërmjetësuese dhe ofrimi i shërbimeve në të gjitha aktivitetet që lidhen me të, etj.

Distributori ushtron ndër të tjera, aktivitetin e ripaketimit, importit, promovimit, marketingut dhe shpërndarjes së produkteve farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore.

Swixx Biopharma AG është prezente në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë *Amicus Pharma SHPK*, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: si primar; hulumtim i tregut dhe sondazh i opinionit publik, marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit, aktivitetet e biznesit dhe aktivitetet e tjera të konsulencës për menaxhimin, si dytësor; kultivimi i erëzave, prodhimi i barnave, produkteve farmaceutike dhe bujqësore, prodhimi i produkteve farmaceutike bazë, prodhimi i preparateve farmaceutike, shitja me shumicë e mallrave farmaceutikë, etj.

**SANOFI WINTHROP INDUSTRIE (Kontraktuesi)** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez, me objekt aktiviteti administrim ndërmarrjesh. SANOFI WINTHROP INDUSTRIE është një filial i Sanofi S.A., një shoqëri e listuar publikisht, me seli në Paris, Francë, aksionet e së cilës tregtohen në Euronext dhe Bursën e New York. Sanofi S.A. është shoqëria mëmë e një grupi global të konsoliduar të kujdesit shëndetësor (Sanofi Group) me objekt aktiviteti: kërkimi, zhvillimi, prodhimi dhe shitja e produkteve të kujdesit shëndetësor.

Në njoftimin për shtyrje, përfaqësuesi ligjor ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës Shtojcën 2 të Marrëveshjes “Njoftim për transferimin e Marrëveshjes Ekskluzive të Shpërndarjes nga Sanofi-Aventis Groupe te Sanofi”, përmes së cilës jemi informuar lidhur me një riorganizim të subjekteve juridike franceze Sanofi, gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes, objekti kryesor i të cilës është konsolidimi dhe thjeshtimi i strukturës ligjore të Sanofit në Francë. Si rezultat i këtij riorganizimi të brendshëm, synohet që aktiviteti i Sanofi-Aventis Groupe

(Transferuesi), për ofrimin e shërbimeve mbështetëse, duke përfshirë shërbimet administrative, teknike, financiare dhe tregtare, si dhe menaxhimin e autorizimeve të marketingut, janë transferuar më datë 1 janar 2023 (Data e Përfundimit), nga një bashkim me SANOFI WINTHROP INDUSTRIE (Përfituesi).

### III. Përshkrimi i marrëveshjes

[...]

Marrëveshja e njoftuar, vlerësohet në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të cilin parashikohet përjashtimi individual nga zbatimi i nenit 4 të tij. Marrëveshjet përjashtohen nga ndalimet e parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003 në rastet kur kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve dhe të konsumatorëve dhe kur:

- Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
- Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

Për sa më sipër, marrëveshja e njoftuar është një marrëveshje vertikale ekskluzive mes një furnizuesi dhe një distributori, e cila ka për qëllim shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme brenda klasave ATC3 ([...]).

### IV. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës” dhe marrëveshjes së depozituar, u analizua tregu përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit përcaktohet nga “produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.

Mbështetur në analizën e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës dhe kërkesës, si dhe rasteve të ngjashme të trajtuara nga autoritete të konkurrencës në tregun farmaceutik, u konstatua se çdo bar xhenerik, është një bar i destinuar për kurimin e një sëmundjeje specifike dhe është i pazëvendësueshëm nga barnat e tjerë xhenerik. Mbi principin aktiv të barit xhenerik dhe shitjes së patentës së tij nga mbajtësit e saj, ndërmarrjet prodhuese farmaceutike krijojnë barnat alternativë të cilët janë zëvendësues të njëri-tjetrit për sa kohë sigurojnë të njëjtën substancë aktive të barit. Parë në këtë këndvështrim, të gjithë barnat alternativë (tregtarë) janë zëvendësues të njëri-tjetrit,

brenda barit xhenerik. Për këto arsye, tregu përkatës i produktit do të përcaktohet në nivelin e barit xhenerik.

Marrëveshja ka të përcaktuar që barnat objekt i saj, i përkasin klasifikimit ATC3 dhe konkretisht klasave [...] dhe për këto arsye, tregu përkatës i produktit, i prekur nga marrëveshja e njoftuar, do të konsiderohet tregu për shitjen me shumicë të produkteve farmaceutike të gatshme të klasave [...] sipas sistemit ATC ([...]).

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën ku ndërmarrjet palë në marrëveshje përfshihen në ofertën dhe kërkesën e produkteve përkatëse, ku kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe mund të dallohen nga zonat gjeografike fqinje, sepse në mënyrë të veçantë, kushtet e konkurrencës janë mjaft të ndryshme nga ato zona.

Rrjedhimisht tregu përkatës gjeografik do të përcaktohet territori kombëtar i Republikës së Shqipërisë.

#### **a. Vlerësimi i marrëveshjes**

Bazuar në nenet 48–52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pikën XI.1 parag. 76 dhe 161 i Udhëzimit “Mbi marrëveshjet vertikale”, marrëveshja e njoftuar nuk ka të parashikuar klauzola të cilat të fiksojnë çmimin, ndajnë tregjet apo kufizojnë prodhimin, sjellje këto të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 9121/2003. Gjithashtu kjo marrëveshje nuk do të ndryshojë strukturën e tregut në vend, duke mos kufizuar, shtrembëruar apo parandaluar konkurrencën në tregun përkatës.

Duke pasur parasysh që pjesa mbizotëruese e aktiviteteve të kërkim zhvillimit, prodhim dhe shitje me shumicë zhvillohet jashtë vendit, nga shoqëria farmaceutike ndërkombëtare me kapital dhe burime të konsiderueshme kërkimore, ka shumë barna dhe trajtime që nuk janë ende në dispozicion në Shqipëri, por potencialisht mund të hyjnë në tregun shqiptar brenda një periudhe të arsyeshme dhe bëhen konkurrentë në klasat përkatëse ATC3.

Ekzistenca e më shumë se një ofruesi të produkteve ekzistuese brenda klasës [...] tregon se tregu është dinamik dhe pjesëmarrjet aktuale të tregut brenda grupit të caktuar të produkteve xhenerike ATC3 nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht një pozicion afatgjatë në treg, i cili (pra pjesëmarrja në treg) ndryshohet shpesh dhe varet nga investimi i tregut në produktet farmaceutike.

Në pikën XI.1 parag. 76 i Udhëzimit “Mbi marrëveshjet vertikale”, parashikohet se “*Vetëm në rastin e furnizimit ekskluziv merret parasysh pjesa e tregut të blerësit, dhe vetëm ajo pjesë tregu, që është vendimtare për zbatimin e vendimit për përjashtim*”

Tregu i produkteve Swixx me recetë (Rx) në Shqipëri nuk mbivendoset me klasat ATC3 të produkteve të Sanofit dhe për këto arsye Marrëveshja nuk ndikon në pjesëmarrjen në treg të Sanofit në lidhje me Produktet e Marrëveshjes.

Pas implementimit të Marrëveshjes, kushtet konkurruese të tregut do të mbeten të njëjta sepse Swixx Biopharma do të shpërndajë Produktet brenda portofolit të produkteve që jepen me recetë

nga mjeku të Sanofit, produkte të cilat më parë Sanofi i shpërndante përmes rrjetit të vet të shpërndarës në Shqipëri (shitësve me shumicë të autorizuar).

Periudha e propozuar për shtyrjen e përjashtimit të marrëveshjes deri në 1 janar 2027, nuk pritet të sjellë ndryshime në strukturën e tregut dhe për këtë arsye miratimi i shtyrjes së përjashtimit nuk do të sjellë efekte mbi konkurrencën në treg.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 6, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të shtyjë afatin e përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjes së Distribucionit ndërmjet palëve Swixx Biopharma AG dhe Sanofi Winthrop Industrie.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjes do të jetë deri në datë 1 janar 2027.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1078, Datë 10. 05. 2024**

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E OFRIMIT DHE AKSESIT TË SHËRBIMIT TË INTERNETIT NDAJ NDËRMARRJEVE TË ADMINISTRIMIT DHE NDËRMARRJEVE TË INTERNETIT NË REZIDENCAT E BANIMIT QË KËTO NDËRMARRJE USHTROJNË VEPRIMTARINË**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10. 05. 2024 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE :**

**I. Procedura e ndjekur**

1. Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me vendimin nr. 1025, datë 18.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit

të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023.

2. Në zbatim të këtij vendimit, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet e administrimit dhe nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e aksesit të internetit.

## **II. Analiza e konkurrencës**

### **II.1 Tregu përkatës**

3. Në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
4. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1025, datë 13.10.2023 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit”, tregu përkatës i produktit përfshin tregun e aksesit të shërbimit të internetit në rezidencat përkatëse të banimit.
5. Në rezidencat e banimit në Tiranë, ndërmarrjet e administrimit menaxhojnë infrastrukturën e shërbimit të internetit. Për më tepër, këto ndërmarrje bëjnë lidhjet me kompanitë e ofrimit të shërbimit të internetit dhe banorëve të cilët duan të përfitojnë këtë shërbim. Në të tilla kushte, ndërmarrjet e administrimit kanë ndikim në tregun e ofrimit të shërbimit të internetit në rezidencat ku ata operojnë. Pra, bazuar në këto fakte, tregu përkatës përfshin tregun e shërbimit të internetit në rezidencat përkatëse të banimit.
6. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët që ata administrojnë.
7. Për sa më sipër, tregu përkatës gjeografik për ndërmarrjet e administrimit në rezidencat e banimit është qarku i Tiranës.

## **III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese**

8. Në bazë të nenit 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121/2003, “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të

penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.”

9. Sipas ligjit, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.
10. Për të përcaktuar pjesët e tregut të ndërmarrjeve që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku të ishte përcaktuar xhiro dhe fitimi për secilën ndërmarrje administrimi që vepron në qarkun e Tiranës. Në informacionin e depozituar nga DPT, për një pjesë të madhe të ndërmarrjeve mungonin të dhënat përsa i përket xhiros dhe fitimit dhe për këtë arsye, është e pamundur që të llogariten pjesët e tregut për secilën ndërmarrjen administrimi në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit.
11. Duke vlerësuar pengesat e hyrjes në treg, konkurrencën potenciale dhe kundërveprimin e fuqisë blerëse, asnjë nga ndërmarrjet e administrimit nuk përmbush kriteret e nenit 8 të Ligjit nr. 9121/2003.
12. Ndërmarrjet që administrojnë rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës e ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm brenda rezidencës që ato administrojnë dhe përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre nuk kanë fuqi jashtë territorit të sipërfaqes së përbashkët të administruar prej tyre. Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, Kryesia, në emër dhe për llogari të Asamblesë, lidh kontratë me një shoqëri administrimi duke i dhënë kësaj të fundit të drejtën ekskluzive për administrimin e bashkëpronësisë.
13. Pjesë e objekteve në bashkëpronësi të ndërtesave konsiderohet dhe pika e aksesit në godinë sipas pikës 18 të VKM-së nr. 189, datë 30.03.2022 “Për përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”, e cila përcakton gjithashtu, në pikën 32 të saj, se administrimi i pikës së aksesit në godinë bëhet pikërisht nga administrator i godinës, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit dhe në përputhje me nenin 21, të Ligjit nr. 120/2016.



14. Për sa më sipër, të gjitha ndërmarrjet e administrimit, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121/2003, vlerësohen me pozitë dominuese në tregun e aksesit të shërbimit të internetit brenda kufijve të rezidencave që ata administrojnë.

#### **IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës**

15. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit në rezidencat e banimit të qarkut të Tiranës në tregun e aksesit të shërbimit të internetit, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 13 tetor 2023, është realizuar në vijim të kërkesës për informacion drejtuar ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve që ofrojnë shërbimin e internetit.
16. Ndërmarrja XXX administron 4 rezidenca banimi në qarkun e Tiranës, të cilat janë:
- Në godinën pranë kompleksit “XXX”, me adresë në rruga “XXX”, nd. 35, njësia administrative nr. XXX, administron 3 shkallë me një numër total prej 82 banesash.
  - Në kompleksin “XXX” me adresë në rruga “XXX”, njësia administrative nr. XXX, administron 41 shkallë me një numër total prej 1351 banesash.
  - Në godinën “XXX”, me adresë në rruga “XXX”, njësia administrative nr. XXX, administron 3 shkallë me një numër total prej 79 banesash.
  - Në kompleksin “XXX”, me adresë në rruga “XXX”, njësia administrative nr. XXX, administron 5 shkallë me një numri total prej 137 banesash.
17. Në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjes së administrimit XXX, e cila zotëron pozitë dominuese në rezidencat në të cilat ka deklaruar se administron, pozitë kjo e fituar në bazë të nenit 19 të ligjit nr. 10 112/2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, vihet re se:
- Ndërmarrja XXX ka përcaktuar një pagesë më të lartë në kontratën e lidhur me “XXX” në favor të operatorit “XXX” për aksesin në infrastrukturën fizike të kompleksit “XXX”, në vlerën mujore prej XXX Lekë për çdo shkallë përfshirë tarifën e TVSH-së, ndërkohë që në kontratat e lidhura me operatorë të tjerë në këtë kompleks, përkatësisht “XXX” dhe “XXX”, kjo tarifë mujore reduktohet në XXX Lekë për çdo shkallë, duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, sjellje e cila mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa c) e Ligjit nr. 9121/2003.
  - Ndërmarrja XXX ka parashikuar në kontratat e lidhura me operatorët “XXX”, “XXX”, “XXX”, “XXX” dhe “XXX” (XXX) në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, detyrimin për të hequr infrastrukturën fizike me përfundimin ose zgjidhjen e kontratës, duke përbërë një detyrim shtesë i cili nuk ka lidhje me objektin e kontratave në fjalë, sjellje e cila mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa ç) e Ligjit nr. 9121/2003.

- Ndërmarrja XXX ka marrë përsipër detyrimin në kontratën e lidhur me operatorin “XXX” për të konsideruar “XXX” si operator preferencial për ta referuar te banorët e kompleksit rezidencial, duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, sjellje e cila mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2, germa c) e Ligjit nr. 9121/2003.
18. Sjellja e ndërmarrjes XXX mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
19. Ndërmarrja XXX, administron 2 rezidenca në Tiranë,
- kompleksin "XXX" i ndodhur në kryqëzimin e Rr. "XXX" me Rr. "XXX", më një numër total prej 450 hyrjesh/apartamente.
  - kompleksin "XXX" i ndodhur në Rr. "XXX", Tiranë, me një numër total prej 355 hyrjesh/apartamente.
20. Nga të dhënat e administruara nga shoqëria e administrimit XXX si edhe nga operatorët e ofrimit të shërbimit të internetit në kompleksin “XXX” dhe në rezidencën “XXX”, vihet re se ka problematika dhe pengesa të shumta në ofrimin e këtij shërbimi.
21. Në kompleksin “XXX”, operatorët e shërbimit të internetit nuk lejohen nga shoqëria e administrimit XXX të ofrojnë shërbimin, duke kufizuar numrin e operatorëve në rezidencë. Në këtë rezidencë shihet qartë prezenca e lartë e ndërmarrjes XXX, e cila ka 346 abonentë nga 450 hyrje gjithsej të kompleksit, duke e bërë këtë operator të zotërojë 76.8% të hyrjeve në kompleks përsa i përket shërbimit të internetit.
22. Në rezidencën “XXX”, ndërmarrjet e shërbimit të internetit nuk kanë prezencë, si edhe ndërmarrja XXX ka shprehur se nuk është lejuar të ofrojë shërbim në këtë rezidencë, ashtu si edhe në rezidencën “XXX”.
23. Sjellja e ndërmarrjes XXX në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
24. Ndërmarrja XXX administron XXX, në Rr. "XXX", Tiranë, e cila në total ka 180 apartamente brenda rezidencës.
25. Si rezultat, nga të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, konstatohet se ndërmarrja XXX në qendrën “XXX”, ka refuzuar aksesin për katër ndërmarrje

(XXX, XXX, XXX dhe XXX) ndërsa ndërmarrjet e tjera (XXX, XXX dhe XXX) janë shprehur se nuk kanë abonentë.

26. Ndërmarrja XXX (XXX) ka rreth 130 abonentë, në qendrën “XXX”, e cila administrohet nga XXX. Qendra “XXX” ka rreth 180 apartamente, ku 72% të abonentëve i ka ndërmarrja XXX.
27. Ndërmarrja XXX dhe XXX (XXX) kanë aksionarë të përbashkët.
28. Gjatë inspektimit, XXX është shprehur se pusi ku kalojnë fibrat për shërbimin e internetit, qëndron i mbyllur dhe kontrollohet nga inxhinieri i cili ndodhet në zyrën e administrimit.
29. Sjellja e ndërmarrjes XXX në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
30. Ndërmarrja XXX administron 8 rezidenca banimi në qarkun e Tiranës dhe një rezidencë banimi në qarkun e Durrësit. Rezidencat e banimit të cilat administron në qarkun e Tiranës janë:
  - Godina XXX, e cila ka rreth 200 njësi (apartamente, dyqane dhe zyra),
  - Godina XXX, e cila ka rreth 170 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Godina XXX, e cila ka rreth 120 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Godina XXX, e cila ka rreth 210 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Godina XXX, e cila ka rreth 55 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Kompleksi XXX, e cila ka rreth 600 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Kompleksi XXX, e cila ka rreth 300 njësi (apartamente dhe dyqane),
  - Kompleksi XXX, e cila ka rreth 30 njësi (apartamente dhe vila).
31. Si rezultat, nga të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, konstatohet se ndërmarrja XXX, në mesin XXX që administron, ka refuzuar aksesin për 3 ndërmarrje (XXX, XXX dhe XXX) ndërsa 3 ndërmarrje të tjera (XXX, XXX dhe XXX) janë shprehur se nuk kanë abonentë. Godina XXX ka rreth 200 njësi, në të cilat XXX ka 14 abonentë dhe XXX shprehet se ka 51 abonentë, pra 25% të njësisve të banimit.
32. Nga të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, konstatohet se:
  - ndërmarrja XXX, në mesin XXX që administron, ka refuzuar aksesin për 3 ndërmarrje (XXX, XXX dhe XXX) ndërsa 4 ndërmarrje të tjera (XXX, XXX, XXX dhe XXX) janë shprehur se nuk kanë abonentë. Qendra XXX ka rreth 170 njësi, në të cilat XXX është shprehur se ka 74 abonentë, pra 43.5% të njësisve të banimit.

- ndërmarrja XXX, në rezidencën XXX që administron, ka refuzuar aksesin për 3 ndërmarrje (XXX, XXX dhe XXX) ndërsa 4 ndërmarrje të tjera (XXX, XXX, XXX dhe XXX) janë shprehur se nuk kanë abonentë. Rezidenca XXX ka rreth 210 njësi, në të cilat XXX është shprehur se ka 110 abonentë, pra 52.4% të njësive të banimit.
  - ndërmarrja XXX, në rezidencën XXX që administron, ka refuzuar aksesin për 3 ndërmarrje (XXX, XXX dhe XXX) ndërsa 4 ndërmarrje të tjera XXX, XXX, XXX dhe XXX) janë shprehur se nuk kanë abonentë. Rezidenca XXX ka rreth 300 njësi, në të cilat XXX është shprehur se ka 368 abonentë, pra rreth 23% më shumë se kapaciteti i njësive të banimit.
  - Në lidhje me 4 rezidencat e tjera (XXX, XXX, XXX dhe XXX) për të cilat XXX është shprehur që administron, nuk kemi informacion nga ndërmarrjet që ofrojnë internet, për shkak se gjatë procedurës së inspektimit ndërmarrja XXX nuk i ka përmendur.
  - XXX dhe XXX (XXX) kanë aksionerë të përbashkët ndërmarrjen XXX.
  - Gjatë inspektimit, XXX u shpreh se XXX ka krijuar infrastrukturën në komplekset dhe pallatet që ata administrojnë dhe duke qenë se ai ka krijuar infrastrukturën operatorët e tjerë e marrin shërbimin nëpërmjet tij. Klientët drejtohen tek XXX për të vijuar kontratën me XXX ose nëpërmjet XXX me operatorë të tjerë.
33. Sjellja e ndërmarrjes XXX në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
34. Ndërmarrja XXX administron 2 rezidenca në Tiranë:
- Kompleksin rezidencial “XXX”, i ndodhur në XXX, Tiranë, me një numër total prej 155 vilash.
  - Rezidencën “XXX” e ndodhur në Rr. "XXX", Tiranë, me një numër total prej 176 apartamentesh.
35. Nga të dhënat e administruara nga shoqëria e administrimit XXX si edhe nga ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit në kompleksin rezidencial “XXX” është vënë re se, ndërmarrja e administrimit ka kontrata me kushte të njëjta për të gjithë operatorët, të cilët duan të ofrojnë shërbimin e internetit në këtë kompleks. Megjithatë, pjesë e kontratave me ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit është edhe pika 5.6 e nenit 5 “Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit”, kjo dispozitë kufizon të drejtën e aksesit për ofrimin e shërbimit të internetit si dhe shfaqet në kundërshtim me nenin 9, pika 2, germa ç) e Ligjit nr. 9121/2003, duke parashikuar se: “XXX ka të drejtë, pa njoftim paraprak të pezullojë gëzimin e të drejtave sipas kësaj Kontrate nga ana e Qiramarrësit, duke përfshirë por pa u kufizuar në ndalimin e aksesit të personelit të Operatorit të Internetit në brendësi të ambienteve të Rezidencës, në rast se Qiramarrësi nuk përmbush detyrimin për pagesën e ndonjë fature për detyrim qiraje ose kamatëvonesave brenda afateve të parashikuara në këtë Kontratë.”

36. Nga të dhënat e administruara nga ndërmarrja e administrimit XXX si edhe nga operatorët e ofrimit të shërbimit të internetit në rezidencën “XXX”, vihet re se, nuk ka problematika në ofrimin e këtij shërbimi. Në rezidencën “XXX”, tregu është i hapur për të gjithë operatorët e ofrimit të shërbimit të internetit dhe shoqëria e administrimit nuk aplikon asnjë tarifë për shfrytëzimin e infrastrukturës së rezidencës. Ndërmarrjet e ofrimit të shërbimit të internetit nuk kanë shfaqur asnjë ankesë për rezidencën “XXX”.
37. Për sa më sipër në përfundim të analizës, sjellja e ndërmarrjes XXX mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, në kompleksin rezidencial “XXX”.
38. Ndërmarrja XXX administron 12 objekte banimi në qarkun e Tiranës si më poshtë:
- Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 100 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 85 hyrje,
  - Godina XXX ndodhur në rrugën XXX me 27 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 36 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 28 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 19 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 33 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 31 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 27 hyrje,
  - Rezidencën XXX, në rrugën XXX me 883 hyrje,
  - Rezidencën XXX, në rrugën XXX me 291 hyrje,
  - Ndërtesa XXX ndodhur në rrugën XXX me 20 hyrje.
39. Rezulton se ortak i vetëm i ndërmarrjes XXX është Z. XXX, ndërsa ndërmarrja XXX ka dy ortakë: Z. XXX me 65% dhe Z. XXX me 35%. Si rezultat, me Z. XXX që zotëron shumicën e pjesëve të ortakërisë në XXX, të dy ndërmarrjet kanë pronësi të njëjtë.
40. Si rezultat, nga të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, konstatohet se ndërmarrja XXX në rezidencat XXX, ka refuzuar aksesin për gjashtë ndërmarrje (XXX, XXX, XXX, XXX, XXX dhe XXX).
41. Ndërmarrja XXX ka 870 abonentë, në rezidencat XXX dhe XXX, e cila administrohet nga XXX. Këto rezidenca kanë së bashku rreth 1 174 hyrje, ku 74% të abonentëve i ka ndërmarrja XXX.

42. Sjellja e ndërmarrjes XXX në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
43. Ndërmarrja XXX administron rezidencën e banimit “XXX”, i cili ka 6 objekte banimi në qarkun e Tiranës sipas listës më poshtë:
- Objekti XXX ndodhur në rrugën e XXX me 3 shkallë/96 hyrje,
  - Objekti XXX ndodhur në rrugën e XXX me 2 shkallë/60 hyrje,
  - Objekti XXX ndodhur në kryqëzimin e rrugës së XXX me XXX me 2 shkallë/55 hyrje,
  - Objekti XXX ndodhur në rrugën e XXX me 4 shkallë/103 hyrje,
  - Objekti XXX ndodhur në rrugën e XXX me 6 shkallë/182 hyrje,
  - Objekti XXX ndodhur në rrugën XXX me 5 shkallë/149 hyrje.
44. Si rezultat, nga të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, konstatohet se ndërmarrja XXX në rezidencën XXX, ka refuzuar aksesin për ndërmarrjen XXX.
45. Ndërmarrjet, XXX (XXX) dhe XXX shprehen se nuk kanë abonentë, por nuk shprehen nëse i refuzohet aksesin apo jo.
46. Sjellja e ndërmarrjes XXX në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.
47. Ndërmarrja XXX administron 9 objekte në kompleksin e banimit XXX, të cilat kanë në total 491 hyrje banimi.
48. Në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjes XXX, nuk evidentohen elementë të abuzimit me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
49. Ndërmarrja XXX administron 5 rezidenca banimi në qarkun e Tiranës, të cilat janë:
- Kompleksi XXX me adresë në XXX, i cili ka rreth 188 apartamente,
  - Kompleksi XXX me adresë në XXX, i cili ka rreth 170 apartamente,
  - Kompleksi XXX me adresë në XXX, i cili ka rreth 195 apartamente,
  - Godina XXX me adresë në XXX, e cila ka rreth 27 apartamente,
  - Kompleksi XXX me adresë në XXX, i cili ka rreth 113 apartamente.
50. Në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjes XXX, nuk evidentohen elementë të abuzimit me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

51. Nga informacioni i administruar nga ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e internetit, është evidentuar se ekzistojnë problematika për kufizimin e aksesit nga ndërmarrje të tjera të administrimit në rezidencat e banimit në qarkun e Tiranës.
52. Sa më sipër, duke u nisur nga fakti se disa nga ndërmarrjet e administrimit kanë aksionarë të përbashkët me ndërmarrjet e internetit, dhe ushtrojnë veprimtarinë në të njëjtën rezidencë banimi, duke sjellë kështu një integrim vertikal, ngrihen dyshime që në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit mund të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.
53. Si konkluzion, sa më sipër, në përfundim të analizës së sjelljes së ndërmarrjeve të administrimit, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e ndërmarrjeve të administrimit mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë këtë shërbim; duke zbatuar kushte të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët dhe duke krijuar kushtet e favorshme për krijimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve të internetit brenda rezidencës që ata administrojnë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
- III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1079, Datë 24. 05. 2024**

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjetellës Kanalizime Durrës SHA.

**Bazë ligjore:** Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Durrës SHA,

**VËREN SE:**

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 134/9 prot., datë 18.04.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 47 prot., datë 10.11.2023, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Durrës SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjetellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Durrës SHA më datë 13.07.2022, bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.



2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), jo për të gjitha njësitë, të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Tarifat e miratuara janë sipas vendimit të KKRR nr. 31, datë 18.07.2017 për Bashkinë Durrës dhe Shijak, Vendimin e KKRR nr.29 datë 30.06.2010 për Bashkinë Kavajë, Vendimin e KKRR nr. 52 datë 28.10.2019 për Bashkinë Krujë dhe Vendimin e KKRR nr. 39 datë 27.12.2012 për Bashkinë Rrogozhinë. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2024; 2025, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes
5. Ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektiv kryesor i ndërmarrjes për vitin 2024, 2025. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese. Pas riorganizimit të sektorit është themeluar ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA për të cilën po miratohen tarifa të ndryshuara pas analizës së kryer.
6. Aktualisht për Zonën A - Bashkia Durrës dhe Shijak, tarifat për FU janë më të lartat në rajon pasi ka kostot më të larta dhe ka dy impiante trajtimi të KUN në funksionim. Shoqëria në këtë aplikim ka kërkuar vetëm rishikim të tarifave për klientët jo familjarë. Është pranuar si i arsyeshëm propozimi i shoqërisë për klientët publike ndërsa tarifat për klientët privat nuk janë pranuar në nivelin e kërkuar nga shoqëria, por është parë e arsyeshme të respektohet klauzola e metodologjisë së tarifave lidhur me koeficientin e ndërfinancimit të tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë. Në këtë propozim tarifat fikse janë pranuar të

unifikuara për të tre zonat A,B,C sipas propozimit të shoqërisë. Gjithashtu tarifat volumetrike për KUN për të tre zonat janë pranuar të diferencuara sipas propozimit të shoqërisë.

7. Tarifa për klientët familjare për Zonën B (Bashkia Kavajë) është pranuar propozimi i shoqërisë si një rritje e arsyeshme në këtë aplikim duke patur parasysh edhe kostot e larta të kësaj njësie. Referuar tarifave për klientët publik dhe private të njësisë Kavajë, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi i koeficientit të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjare me ato jo familjare.
8. Tarifa për klientët familjarë për Zonën C (njësitë Krujë dhe Rogozhinë) është pranuar propozimi i shoqërisë si një rritje e arsyeshme në këtë aplikim për njësinë Krujë duke patur parasysh kostot e larta të kësaj njësie si rezultat investimit të ri në stacionin e pompimit Hasan, si edhe unifikimi i saj me tarifën ekzistuese të njësisë Rogozhinë e cila në këtë aplikim nuk është kërkuar të ndryshohet nga shoqëria.
9. Referuar tarifave për klientët publike dhe private të këtyre dy njësive, nuk është pranuar propozimi i shoqërisë për FU, por është parë e arsyeshme të respektohet aplikimi pothuajse i koeficientit dy (2) të ndërfinancimit të përcaktuar në metodologjinë e tarifave ndërmjet klientëve familjarë me ato jo familjarë.
10. Ndërmarrjen Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA propozon tarifat e reja si rezultat në nevojën për përmirësim të performancës financiare dhe mbulimin 100% të kostove operacionale duke qenë se është një shoqëri me kosto shumë të larta të energjisë elektrike; aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së cmimeve të materialeve dhe pagës minimale; reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele shumë të larta; përmirësim i cilësisë së shërbimit të ujit me rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; tarifat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.
11. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12.2021, lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2024; vitin 2025 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundur reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.

12. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 55.04 % për vitin 2022 me një rritje 57.96 % për në fund të vitit 2025. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 31.84 % për vitin 2022 me një rritje 57.6 % për në fund të vitit 2025.
13. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA duhet të instaloj matëset në burim (Bulk metër), si edhe matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes; të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet; të organizojë taks - forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë, Rrogozhinë për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale; të trajnojnë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura; të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2023, vitin 2024 e në vazhdim; të gjejnë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit, i cili shkakton humbje fizike në nivele të lartë; të mbaj nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimeve të defekteve, për të minimizuar sa me shumë humbjet nga rrjedhjet; të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet; Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t’u realizuar në vitin 2024.
14. Në aspektin ekonomik, ERRU gjykon se, ndërmarrja Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA duhet të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të asetëve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim, që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimit të parashikuar për t’u realizuar në vitin 2024; të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si; monitorimi i klientëve, ndërprerja e shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesat bankare apo pagesa online; të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri; të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin

e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m<sup>3</sup> ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë;
- Të hartojë një data basë me të gjithë konsumin e energjisë (bazuar tek matësit, faturat e energjisë etj.) duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos;
- Të krahasoj dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim;
- Të realizojë trajnime për efikasitetin e energjisë për stafin operativ.

15. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura”, ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e përdorura dhe tarifatat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjellës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizimeve”, ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

16. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.

17. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:

- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.

- b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjellës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
  - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
  - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
  - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
18. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësijellës Kanalizimeve.
19. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësijellës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:
- a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësijellës Kanalizime Durrës SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
  - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrja Rajonale Ujësijellës Kanalizime Tirane SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
  - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
20. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrjen Rajonale Ujësijellës Kanalizime Durrës SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar

ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA.

21. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifatat variabël të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA, por jo në nivelet që propozon ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjiellës kanalizime”, duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifatat (kostot operacionale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2022) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.
22. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021, përmban dhe aprovimin e prezantimit për në seancën dëgjimore me publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Durrës, Roskovec dhe Mallakastër, si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA, konstatohet se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.
23. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).
24. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

- I. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:
1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
  2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
  3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, si edhe në ndërmarrjen Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.
  4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1080 , Datë 24. 05. 2024**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË TËRTHORTË TË ASETVE NË PRONËSI TË KOMERCIJALNA BANKA AD NGA SHOQËRIA YILDIRIM INTERNATIONAL INVESTMENT HOLDING B.V.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:**

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të asetve në pronësi të KOMERCIJALNA BANKA AD nga shoqëria Yildirim International Investment Holding B.V.

**Baza Ligjore:**

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të asetve në pronësi të KOMERCIJALNA BANKA AD nga shoqëria Yildirim International Investment Holding B.V.,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të tërthortë të asetve në pronësi të KOMERCIJALNA BANKA AD nga shoqëria Yildirim International Investment Holding B.V.

Referuar dokumenteve të depozituara nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:



**Blerësi 1:** KINGMAN REFRACTORIES DOOEL Skopje është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, me objekt aktiviteti prodhimin e produkteve rezistente ndaj zjarrit.

**Blerësi 2:** DOUBLE EAGLE NICKEL DOOEL Skopje është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, me objekt aktiviteti prodhimin e metaleve të tjera me ngjyra.

Të dyja shoqëritë blerëse janë krijuar për qëllime të këtij transaksioni dhe janë pjesë e Grupit Yildirim.

Grupi Yildirim operon në një numër të madh industrish si: metalurgji dhe miniera, qymyre dhe coke, energji, plehra kimike ose fertilizues dhe kimikate, menaxhim porti, transport, logjistik etj.

Grupi Yildirim është aktiv dhe realizon të ardhura në Shqipëri, indirekt nëpërmjet filialeve të tij:

- **Yildirim Albania Mining Investments SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti blerjen, mbajtjen dhe transferimin e pjesëmarrjeve në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, financimi i këtyre shoqërive dhe ndërmarrjeve, marrja dhe dhënia e huave etj.
- **Albchrome Holding SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: menaxhimi, aktivitetet mbështetëse për industrinë e minierave, shërbimet për mineralet jo-metalike etj.

Albchrome Holding ka dy filiale në pronësi të plotë:

*Albchrome SHPK* është prodhuesi më i madh i kromit dhe ferrokromit në Shqipëri, i cili operon nëpërmjet dy kontratave të koncesionit; atë të ndërtimit, operimit dhe transferimit të uzinës së ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Përrenjasit e Pojskës, si dhe kontrata e koncesionit për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit dhe të uzinës së ferrokromit Burrel.

*Vllahen Mining SHPK* operon në fushën e xeheror-kromit në Has, Shqipëri.

Shoqërinë *NewCo Ferronikeli Complex SHPK* (M01810010D), një filial i zotëruar indirekt nga Grupi Yildirim, nëpërmjet *NewCo Ferronikeli Complex SHPK*, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Kosovës.

**Target:** Asetet e shoqërisë Euronickel Industry DOO, të cilat janë asete të hekur nikelit dhe asetet e shoqërisë Nova Refraktori DOO, të cilat janë asete zjarrduruese. Aktualisht këto asete zotërohen nga KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE si kolateral dhe përbëhen nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

**Shitësi:** KOMERCIJALNA BANKA AD Skopje është një bankë tregtare, e themeluar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, aktiviteti tregtar i së cilës janë shërbimet bankare.

## II. Përqendrimi

Më datë 22 mars 2024, shoqëritë KINGMAN REFRACTORIES DOOEL Skopje në cilësinë e blerësit dhe KOMERCIJALNA BANKA AD Skopje, në cilësinë e shitësit, kanë nënshkruar “Marrëveshje Shitblerje” për blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme duke siguruar çmimin e shitblerjes me hipotekë dhe “Marrëveshje Shitblerje” për blerjen dhe shitjen e pasurive të luajtshme.

Po në këtë datë, shoqëritë DOUBLE EAGLE NICKEL DOOEL Skopje, në cilësinë e blerësit dhe KOMERCIJALNA BANKA AD Skopje, në cilësinë e shitësit, kanë nënshkruar “Marrëveshje Shitblerje” për blerjen dhe shitjen e pasurive të paluajtshme duke siguruar çmimin e shitblerjes me hipotekë dhe “Marrëveshje Shitblerje” për blerjen dhe shitjen e pasurive të luajtshme, më parë në pronësi të EURONICKEL INDUSTRY DOO.

Referuar marrëveshjeve të shitblerjes për blerjen dhe shitjen e pasurive të luajtshme, asetet objekt i transaksionit janë asetet e ferronikelit, të cilat përfshijnë të gjithë linjën e prodhimit dhe pajisjeve mbështetëse për prodhimin dhe furnizimin e hekur nikelit dhe asetet zjarrduruese, ku përfshihet impianti zjarrdurues, i cili do të mbështesë furnizimin me kimikate ferrokrom dhe krom, si dhe tulla zjarrduruese, për të përmbushur nevojat e brendshme të impianteve të hekur nikelit. Sipas vlerësimit të palës njoftuese, prodhimi dhe furnizimi i produkteve zjarrduruese është një aktivitet i domosdoshëm për prodhimin e hekur nikelit dhe nënprodukteve të lidhura me hekur nikelin.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose aseteve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteve. Përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.”

Nga vlerësimi i dokumentacionit konstatohet se asetet, objekt i transaksionit të propozuar, kanë krijuar xhiro kur ishin në pronësi të shoqërive Nova Refraktori DOO Pehchevo dhe EURONICKEL INDUSTRY DOO, duke i krijuar të ardhura këtyre shoqërive.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të hekur nikel dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Blerësit, KINGMAN REFRACTORIES DOOEL Skopje dhe DOUBLE EAGLE NICKEL DOOEL Skopje zotërohen nga Grupi Yldirim, i cili është aktiv në nivel ndërkombëtar në sektorin

minerar.

Grupi Yildirim është aktiv në Shqipëri indirekt nëpërmjet filialeve të tij: Albchrome Holding SHPK dhe NewCo Ferronikeli Complex SHPK dhe realizon të ardhura nëpërmjet shoqërisë Albchrome Holding SHPK.

Shoqëria Albchrome Holding SHPK, është aktive në fushën e menaxhimit, aktiviteteve mbështetëse për industrinë e minierave, shërbimet për mineralet jo-metalike, është prezente dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet dy filialeve të saj, Albchrome SHPK dhe Vllahen Mining SHPK. Albchrome SHPK është prodhuesi më i madh i kromit dhe ferrokromit në Shqipëri dhe Vllahen Mining SHPK operon në fushën e xeheror-kromit.

Ndërkohë, NewCo Ferronikeli Complex SHPK është licencuar për shfrytëzimin e rezervave të mineralit të hekur nikelit dhe nuk ka gjeneruar asnjë të ardhur, pasi kjo shoqëri është ende në fazën e investimit.

Transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të tërthortë të aseteve në pronësi të KOMERCIJALNA BANKA AD Skopje nga shoqëria Yildirim International Investment Holding B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1081, Datë 24. 05. 2024**

**“MBI PEZULLIMIN E AFATEVE TË PROCEDURËS SË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR TRANSAKSIONIN E PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PHARMA ONE SHPK NGA SHOQËRITË MED LAB SHPK, EVITA SHPK DHE FARMACOM SHPK DHE FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONTROLLIT PËR TRANSAKSIONET E PA NJOFTUARA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24 . 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:**

Mbi pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK dhe fillimin e procedurës së kontrollit për transaksionet e pa njoftuara.

**Baza Ligjore:**

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Procedura**

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën 125 prot., datë 29.01.2024 “Kërkohet autorizimi për miratimin e “Marrëveshjes për Shit-blerjen e Kuotës”, datë 19.04.2024 lidhur ndërmjet shoqërisë “MED LAB” SHPK dhe Z. Ben Petani për shit-blerjen e Kuotës që përfaqëson 33.34% (tridhjetë

e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë “Pharma One” SHPK” është njoftuar në lidhje me transaksionin e shitblerjes së kuotës tek shoqëria Med Lab SHPK, që z. Ben Petani zotëron në shoqërinë PHARMA ONE SHPK.

Në zbatim të nenit 54 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Rregullores “Për procedurat e kontrollit të përqendrimeve”, me shkresën nr. 125/3 prot., i AK, datë 20.05.2024, Autoriteti i Konkurrencës ka dërguar konfirmimin e marrjes së njoftimit tek shoqëria PHARMA ONE SHPK.

## **II. Transaksioni i I**

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, më datë 25 qershor 2018 ndërmjet shoqërive Evita SHPK (blerësi) dhe z. Ben Petani (shitësi) është nënshkruar Kontrata për shitblerjen e kuotës. Referuar kësaj kontrate, shitësi i ka shitur blerësit kuotën e tij, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK (shoqëria target).

### ***Palët në transaksion:***

**Blerësi:** Evita SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike; import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve dhe aksesoreve të tyre etj.

**Shoqëria target:** PHARMA ONE SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e angazhuar në fushën e tregtisë ku do të kryejë tregtimin me shumicë dhe pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore dhe artikujve farmaceutikë, lëndëve të para, aksesorë, para farmaceutike, tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme si pajisje mjekësore industriale e artikujve të ndryshme, elektrike, mekanike, elektronike, cigare të të gjitha llojeve, industriale, ushqimore, të ndërtimit, të mediave, të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit etj.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target PHARMA ONE SHPK zotërohet 50% nga z. Ben Petani dhe 50% nga shoqëria Evita SHPK. Kontrata e nënshkruar nga palët ka sjellë për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga kontroll i vetëm në kontroll të përbashkët.

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, transaksioni përbën përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të përfuturit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe z. Ben Petani.

## **III. Transaksioni i II**

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, më datë 06.03.2020 ndërmjet shoqërive

FARMACOM SHPK (blerësi), z. Ben Petani (shitësi 1), Evita SHPK (shitësi 2), znj. Xhulieta Petani (dhënësjë e pëlqimit për shitësin 1), është nënshkruar “Kontratë Shitje e Kuotave të Kapitalit”. Referuar kësaj kontrate, shitësit i kanë shitur blerësit 33.33% të pjesëve të kapitalit themeltar që ata zotërojnë tek shoqëria target PHARMA ONE SHPK.

***Palët në transaksion:***

**Blerësi:** FARMACOM SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave laboratorike mjekësore etj; investime, shërbime e projekte në fushën e mjekësisë e laboratorëve mjekësorë; ndërmarrja e nismave, veprimeve, aktiviteteve e pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme koncesionare, privatizimi apo tenderimi etj.

**Shoqëria Target:** PHARMA ONE SHPK.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target PHARMA ONE SHPK zotërohet 33.34% nga z. Ben Petani, 33.33% nga shoqëria Evita SHPK dhe 33% nga shoqëria FARMACOM SHPK.

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, transaksioni përbën përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të përfundimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.

#### **IV. Transaksioni i III**

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, më datë 27 shkurt 2020, shoqëria PHARMA ONE SHPK (blerësi), Eduard Curraj (shitësi 1) dhe Dorian Sadiku (shitësi 2), kanë nënshkruar “Kontratë shitje e kuotave të kapitalit” të shoqërisë DELTA Med SHPK. Referuar kësaj kontrate, shitësit i kanë shitur blerësit 100% të kuotave të kapitalit themeltar që ata zotëronin në shoqërinë DELTA Med SHPK.

***Palët në transaksion:***

**Blerësi:** PHARMA ONE SHPK.

**Shoqëria Target:** DELTA Med SHPK, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti tregtim të artikujve farmaceutike dhe kozmetike, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji; distributor dhe shpërndarës i barnave dhe medikamenteve mjekësore; import, eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore, etj.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria DELTA Med SHPK zotërohet 100% nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, transaksioni përbën përqendrim në kuptim

të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të përfimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

#### **V. Konstatimi i transaksioneve në shkelje të ligjit**

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: ....b) *ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera.*

Transaksionet e mësipërme nuk janë njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi vëren shkelje në detyrimin për njoftim, fillon me nismën e vet procedurat për kontrollin e përqendrimeve.

Transaksionet e pa njoftuara, kanë sjellë për pasojë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë PHARMA ONE SHPK. Këto transaksione mund të kenë ndikuar në strukturat e tregut dhe për pasojë edhe në transaksionin e datës 19.01.2024, të njoftuar nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.

Neni 57/1 “Pezullimi i Afateve” i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, parashikon pezullim të afateve të parashikuara në nenin 56 “Procedura Paraprake” të këtij ligji.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, pezullon afatet e parashikuara në nenin 56 të ligjit, deri në përfundimin e vlerësimit të procedurave të kontrollit të përqendrimeve për transaksionet e pa njoftuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 57/1, nenit 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Pezullimin e afateve të procedurës së kontrollit të përqendrimeve për transaksionin e përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK nga shoqëritë Med Lab SHPK, Evita SHPK dhe FARMACOM SHPK.

2. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëria Evita SHPK dhe z. Ben Petani.
3. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PHARMA ONE SHPK, nga shoqëritë Evita SHPK, FARMACOM SHPK dhe z. Ben Petani.
4. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të shoqërisë DELTA Med SHPK, nga shoqëria PHARMA ONE SHPK.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**



**VENDIM**

**Nr. 1082 , Datë 06. 06. 2024**

**“MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË PËRQENDRIMEVE PËR RASTIN E KRIJIMIT TË NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT, ECO CLEANING SHPK, NGA ORTAKËT THEMELUES TË SAJ, SHOQËRITË ALKO-IMPEX GENERAL CONSTRUACION SHPK DHE 2 T SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola Delija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 06. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të shoqërisë ECO CLEANING SHPK nga ortakët themelues të saj, ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, neni 29/1, neni 59 dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm për fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të shoqërisë ECO CLEANING SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Procedura**

Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 232/7 prot., datë 09.05.2024 “Kërkesë për informacion nga emisioni “Vetting” në NEWS 24” u njoftua mbi rastin e krijimit të shoqërisë ECO

CLEANING SHPK nga ortakët themelues të saj, ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK.

## **II. Transaksioni**

Referuar informacionit të depozituar sipas shkresës 232/7 prot., datë 09.05.2024 “Kërkesë për informacion nga emisioni “Vetting” në NEWS 24” dhe dokumentacionit të siguruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezulton:

Më datë 30.05.2018, shoqëria ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK kanë themeluar një ndërmarrje të përbashkët, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ECO CLEANING SHPK, ku ALKO-IMPEX General Construcion SHPK zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 95% të kapitalit themeltar dhe 2 T SHPK zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 5% të kapitalit themeltar.

Kapitali i shoqërisë është i ndarë në dy kuota. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote.

### ***Palët në transaksion:***

**1. ALKO-IMPEX General Construcion SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar më datë 26.01.2009, sipas legjislacionit shqiptar.

**2. 2 T SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar më datë 31.05.2000, sipas legjislacionit shqiptar.

**Ndërmarrja e Përbashkët - ECO CLEANING SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e krijuar nga ortakët themelues ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe 2 T SHPK. Shoqëria ka si objekt aktiviteti: Shërbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane nëpërmjet ndërtimit të impiantit të diferencimit për Qytetin e Kamzës dhe transferimi te Autoriteti Kontraktor.

Kapitali i shoqërisë është i ndarë në dy kuota. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote.

Referuar informacionit të depozituar, transaksioni përbën përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi jemi përpara faktit të krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, të shoqërisë ECO CLEANING SHPK.

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Rasti i krijimit të ndërmarrjes ECO CLEANING SHPK nga shoqëria ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK nuk është njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës,

brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pasi vëren shkelje në detyrimin për njoftim, fillon me nismën e vet procedurat për kontrollin e përqendrimeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 59 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimeve mbi rastin e krijimit të ndërmarrjes së përbashkët ECO CLEANING SHPK nga ortakët themelues të saj, shoqëria ALKO-IMPEX General Construcion SHPK dhe shoqëria 2 T SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1083, Datë 06. 06. 2024**

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ  
NDËRMARRJES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK DHE NDËRMARRJES  
AUTO HOLIDAY ALBANIA SHPK NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR  
UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06. 06 .2024 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtare, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 45, neni 70, pika 2 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtare, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA);
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit të thelluar;
- Informacionit mbi krahasimin e tarifave të ofrimit të shërbimit taksi për pasagjerë në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër dhe Korçë;
- Seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 15.01.2024 me ndërmarrjen Tirana International Airport SHPK, Auto Holiday Albania SHPK dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit të Aviacionit Civil;

- Shpjegimet e paraqitura nga ndërmarrja Tirana International Airport SHPK nëpërmjet shkresës nr. 50 prot., datë 15.01.2024 “Mbi raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK”;
- Shpjegimet e paraqitura nga ndërmarrja Auto Holiday Albania SHPK, nëpërmjet shkresës nr. 50/1 prot., datë 15.01.2024 “Parashtesë lidhur me Raportin e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, komunikuar nga ana juaj me shkresën nr. 272/42 prot., datë 28/12/2023;
- Shkresa nr. 50/5 prot., datë 24.01.2024 “Përcjellje informacioni”, e ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK;
- Email i datës 20.01.2024 dërguar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Relacionit mbi dokumentacionin shtesë dërguar nga ndërmarrja Tirana International Airport SHPK dhe Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar.

## VËREN SE :

### I. Procedura e ndjekur

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka monitoruar tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
2. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstatua se, në zonën e jashtme Kiss&Fly e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një tablele me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk lejohet aksesimi nga ndërmarrje të tjera që ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë, ta ofrojnë këtë shërbim nga aeroporti drejt Tiranës nëse nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania. Tirana International Airport SHPK zotëron pozitë dominuese, pasi është i vetmi subjekt i cili ofron facilitetet esenciale në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës.
3. Për sa më sipër, u vlerësua se mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku përcaktohet se përbën abuzim nga ana e një ndërmarrje me pozitë dominuese refuzimi për të ofruar shërbime/produkte duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta konkurrence.
4. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi me Vendimin nr. 984,

datë 11.5.2023 për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 11 maj 2023.

5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës” vendosi marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK për lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe heqjen e tabelës me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të Ligjit nr. 9121/2003.
6. Në kuadër të hetimit paraprak është vlerësuar sjellja e ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun përkatës për të parë nëse jemi para rastit të abuzimit me pozitën dominuese, e cila mund të sjellë kufizimin e konkurrencës në treg, referuar nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
7. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, **Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se, ndërmarrja TIA ka zbatuar VKK nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”.**
8. Tirana International Airport SHPK kishte vendosur në zonën e jashtme Kiss&Fly tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë” brenda territorit të Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, i cili për nga vet natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror si dhe kjo ndërmarrje është poseduese dhe administruese e vetme e infrastrukturës dhe faciliteteve të aeroporti ndërkombëtar të Tiranës, duke zotëruar 100% të pjesëve të tregut përkatës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sjellja e TIA mund të përbente abuzim me pozitën dominuese duke refuzuar aksesin dhe ndërmarrjeve të tjera që janë të licensuara dhe që ofrojnë shërbimin e transportit rrugor të udhëtarëve me taksi nga aeroporti drejt Tiranës apo një destinacioni tjetër.
9. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1013, datë 13.09.2023, **vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar** ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 15 tetor 2023.

10. Në zbatim të këtij vendimi, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK, ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK, Bashkive Krujë, Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Shkodër dhe Korçë.

## **II. Analiza e konkurrencës**

### **II.1. Tregu Përkatës**

11. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
12. Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, për nga vetë natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror. Në këtë facilitet përfshihen të gjitha shërbimet brenda një aeroporti të cilat bëjnë të mundur sigurimin e një pasagjeri për të arritur nga destinacioni A tek B, duke përfshirë kështu edhe shërbimin me taksi nga/drejt Aeroportit TIA.
13. TIA ka përzgjedhur ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK (AHA), e cila është përgjegjëse të ofrojë shërbimin taksi për transport udhëtarësh me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve, që nga viti XXX. Ky subjekt është i licencuar për ofrimin e këtij shërbimi nga Bashkia Krujë dhe realizon transport nga Aeroporti i Tiranës me destinacion vendndodhjen e kërkuar nga pasagjeri.
14. AHA ka një kontratë të gjatë, deri më XXX, për të operuar nga terminali i pasagjerëve të Aeroportit të Tiranës. Kjo i jep AHA-s një avantazh të madh dhe e kufizon qasjen e ndërmarrjeve të tjera në këtë segment të tregut.
15. Ndonëse për krahun drejt TIA-s, ka zëvendësueshmëri dhe konkurrencë sepse në treg operojnë të gjithë taksitë e licencuara nga bashkitë ku gjenerohet udhëtimi drejt TIA-s, e kundërta ndodh në krahun që nisët nga TIA. Konsumatorët janë të kufizuar në zgjedhjen e shërbimit taksi, pasi vetëm AHA ka akses në zonën aeroportuale.
16. Fakti që pasagjerët kanë mundësi të marrin taksi jashtë zonës aeroportuale tregon se ekzistojnë alternativa të mundshme për shërbimin taksi, duke përfshirë shërbimin taksi të ofruar nga ndërmarrje të tjera jashtë terminalit. Kjo lloj konkurrence jashtë terminalit është një faktor që rrit zëvendësueshmërinë nga ana e ofertës.
17. Nga sa më sipër, konstatohet se pjesë e shërbimit taksi për udhëtarë, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, kryhet në territor të administruar nga një ndërmarrje e cila ka pozitë

dominuese. Në rrugët e gjeneruara nga TIA, pikënisja ndodhet brenda territorit të TIA-s dhe mjetet taksi kanë nevojë për akses për të operuar rrugë që gjenerohen nga brenda territorit të TIA. Për këtë arsye merr rëndësi ndarja e tregut përkatës, të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), në dy nivele.

18. Pra, nga sa më lart, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë:

- shërbimin taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA) dhe,
- aksesin e mjeteve taksi në territorin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA).

19. Tregu përkatës gjeografik është Nikël (Rinasi), në të cilin TIA SHPK dhe Auto Holiday Albania SHPK ushtrojnë aktivitetin e tyre pranë Aeroportit “Nënë Tereza” (TIA).

## II.2 Vlerësimi i Pozitës Dominuese

20. Vlerësimi i pozitës dominuese në treg është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të Ligjit, përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

21. Sipas Ligjit nr. 9121/2003, pasja e një pozite dominuese nga një ndërmarrje në treg nuk është e ndaluar, por zotërimi i pozitës dominuese i jep ndërmarrjes një detyrim të veçantë për të mos abuzuar me këtë pozitë dominuese që zotëron dhe të mos kryejë sjellje të ndaluara në treg, veçanërisht nga ato të përcaktuara në nenin 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121/2003.

22. Aeroporti ndërkombëtar i Tiranës, për nga vetë natyra është një facilitet esencial për kryerjen e transportit ajror. Në këtë facilitet përfshihen të gjitha shërbimet brenda një aeroporti të cilat bëjnë të mundur sigurimin e një pasagjeri për të arritur nga destinacioni A tek B, duke përfshirë kështu edhe shërbimin me taksi nga/drejt Aeroportit TIA.

23. TIA-s nëpërmjet Marrëveshjes së Koncesionit, i është dhënë e drejta ekskluzive dhe e vetme që gjatë afatit të koncesionit të ndërtojë, të vendosë në punë, operojë dhe mirëmbajë aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe është subjekti i vetëm që menaxhon (vetë ose nëpërmjet nënkontraktorëve) zonën e koncesionit, ku përfshihet dhe zona Kiss & Fly (vendqëndrimi i shpejtë i lënies dhe marrjes së pasagjerëve, deri në 4 minuta). Bazuar në



marrëveshjen koncesionare për të gjithë periudhën e koncesionit ndërmarrja Tirana International Airport SHPK, operon e vetme pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

24. Duke marrë parasysh pjesët e tregut, barrierat për hyrjen në treg; konkurrencën potenciale; fuqinë kundërvepruese të blerësve, pavarësisht se ndërmarrja Auto Holiday Albania SHPK është e vetmja ndërmarrje që është përgjegjëse të ofrojë shërbimin taksi për transport udhëtarësh nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve, kjo ndërmarrje nuk vlerësohet me pozitë dominuese në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit ndërkombëtar të Tiranës (TIA).
25. Ndërmarrja TIA në kuptim të nenit 8, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka një pozitë dominuese duke pasur 100% të tregut përkatës. Duke u bazuar në Ligj dhe në Udhëzimin “Për vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese”, por edhe në praktikat më të mira të Komisionit Evropian dhe të OECD, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK, ka një mundësi potenciale të maksimizojë fitimet duke refuzuar aksesin për të ofruar shërbimin me taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës edhe nga ndërmarrje të tjera që ofrojnë shërbimin.

### **II. 3 Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun përkatës**

26. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe shoqëria koncesionare Tirana International Airport SHPK, kanë lidhur marrëveshjen fillestare të koncesionit, më datë 15 tetor 2004 (Marrëveshja fillestare e koncesionit), e ratifikuar përmes Ligjit nr. 9312, datë 11 nëntor 2004, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar ‘Nënë Tereza’, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”. (ndryshuar me Ligjin nr. 55/2016 dhe Ligjin nr. 16/2021).
27. Sipas pikës 2, germa “C”, Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria lidhin këtë Kontratë me qëllim përcaktimin e kushteve dhe afateve në bazë të të cilave Shoqëria, ndër të tjera, ka të drejtë, *inter alias*...:
- a) të projektojë, financojë, instalojë, ndërtojë, vëndosë në punë, mirëmbajë, operojë, administrojë dhe zhvillojë Terminalin e Ri dhe Ndërtimet e Reja dhe Ndërtimet e Reja Shtesë në Zonën e Koncesionit;
  - b) të përdorë dhe të ripajisë Terminalin Ekzistues, Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues, Aktivitet Përkatës dhe Zonën e Koncesionit;
  - c) të ketë në pronësi Ndërtimet e Reja;

- d) të gëzojë Uzufuktin mbi Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues, Aktivet Përkatëse dhe Zonën e Koncesionit për të paktën njëzet (20) vjet<sup>2</sup>; dhe
- e) të lidhë kontrata për blerjen e çdo aktivi, të përmbushë detyrimet dhe ushtrinë të drejtat sipas kësaj Kontrate.
28. Sipas Marrëveshjes Fillestare të Koncesionit, pikës 2.1.a (x) dhe pikës 2.1.a (xii), TIA gëzon të drejtën ekskluzive për zhvillim komercial të Zonës së Koncesionit si dhe të nënshkruajë kontrata të drejtpërdrejta me palët e treta në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.
29. Mbështetur në pikat e mësipërme, të Marrëveshjes Fillestare të Koncesionit, pikës 2.1.a (x) dhe pikës 2.1.a (xii), TIA arsyeton në shkresën e saj nr. 272/9 prot., datë 19.05.2023, se ka të drejtën dhe përgjegjësinë të ofrojë vetë ose nëpërmjet nënkontraktimit të palëve të treta, çdo lloj shërbimi të nevojshëm në aeroport, për përdoruesit e aeroportit, përfshirë këtu edhe transportin e udhëtarëve me taksi nga aeroporti, si ndër alternativa e transportit rrugor, me qëllim udhëtimin nga Aeroporti i Tiranës.
30. TIA për këtë qëllim ka nënshkruar një marrëveshje me një ndërmarrje të licencuar për shërbimin taksi e cila është ndërmarrja Auto Holiday Albania SHPK (AHA).
31. Sipas Ligjit nr. 8308/1998 “Për Transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 35, specifikon se Këshilli Bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimi brenda juridiksionit të vet. Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.
32. Sipas Udhëzimit nr. 1649/1998 pika III/4, Mbi kushtet dhe rregullat e kryerjes së transportit të udhëtarëve me taksi parashikohet se: Kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë rrethit, ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:
- a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;
  - b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.
33. Autovetura taksi mund të prenotohet nga udhëtari, nëpërmjet agjencisë, ose drejtpërsëdrejti nga ai në vendqëndrimin e taksive, ose në ecje e sipër, etj. Shërbimi taksi jashtë territorit të rrethit, sipas shkronjës “b”, kryhet vetëm nëpërmjet agjencive të licencuara për “Agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit”, në përputhje me udhëzimin e licencimit.

---

<sup>2</sup> Ndryshuar sipas ligjit nr. 16/2021 “a) Koncesioni jepet për një afat kohor (tridhjetë e pesë) vjet, duke filluar nga data e fillimit (Afati i koncesionit).”.

34. Ndërmarrja TIA për përzgjedhjen e ndërmarrjes për ofrimin e shërbimit taksi për transport udhëtarësh me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve, ka ftuar të marrin pjesë në procesin e përzgjedhjes kompani që plotësonin kushtet ligjore dhe teknike të parashikuara nga legjislacioni shqiptar. Sipas informacionit të marrë nga TIA dhe shkresës protokolluar pranë AK me nr. 272/9 prot., datë 19.05.2023 *“Përgjigje ndaj njoftimit të vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 984 datë 11.05.2023”*, të dërguar nga TIA, ndërmarrja Auto Holiday Albania është ndërmarrja e vetme e ofruar dhe e përzgjedhur që ofron shërbimin taksi brenda Aeroportit të Tiranës. Por nga dokumentacioni i shtesë kërkuar gjatë seancës dëgjimore, nr. 50/5 prot., datë 24.01.2024, në këtë procedurë rezulton se kanë marrë pjesë 4 ndërmarrje.
35. TIA është shprehur se, referuar Ligjit nr. 8308/1998 *“Për transportet rrugore”*, neni 35, paragrafi 1, ku specifikohet që këshilli bashkiak përcakton mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të këtij shërbimin brenda juridiksionit të vet, duhet të jenë të licensuara nga Bashkia Krujë, ku bën pjesë Aeroporti i Tiranës.
36. TIA në cilësinë e Koncesionarit të Aeroportit ka edhe detyrimin të ruajë standardin dhe cilësinë e shërbimit, prandaj kontrollon që kompanitë përveç kriterit ligjor të plotësojnë dhe kriterin teknik që është jo më pak i rëndësishëm. Këtu përfshihet numri dhe kapaciteti i taksive që ka në dispozicion, qëndrueshmëria e duhur financiare, reputacioni i mire, profesionalizmi, vendosja efektive dhe qëndrueshmëria në bashkinë përkatëse, të cilat janë elementë të rëndësishëm në ofrimin e cilësisë së shërbimit.
37. Referuar sa më lart dhe Kontratës së Shërbimit *“Për shërbimin taksi në Terminalin e Pasagjerëve të Tirana International Airport”* TIA ka përzgjedhur ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK, e cila sipas kushteve dhe termave të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve është përgjegjëse të ofrojë shërbimin taksi për transport udhëtarësh me vendndodhje të mjeteve në zonën e qëndrimit jashtë Terminalit të Pasagjerëve.
38. Referuar nenit 2, të Shtojcës nr.2 *“Për shërbimin në terminalin e pasagjerëve të Tirana International Airport hyrë në fuqi më datë XXX”*, të hartuar në datë XXX, TIA dhe AHA kanë renë dakord të zgjasin afatin e Kontratës së ndryshuar duke filluar nga data XXX deri në datën XXX (kontratë me një afat XXX vjeçar).
39. Në kontratën fillestare të shërbimit *“Për shërbimin taksi në Terminalin e Pasagjerëve të Tirana International Airport”*, TIA ka lejuar AHA të parkojë XXX taksi në ambientet përballë Terminalit të Pasagjerëve në zonën e marrjes së pasagjerëve (referuar si *“Ambientet”*) dhe XXX taksi në zonën e kthesës së ambienteve të parkimit, kundrejt një pagese mujore prej XXX Euro pa TVSH. Referuar Shtojcës nr. 1, të hartuar në XXX, palët kanë rënë dakord se

duke filluar nga data XXX, AHA-s i lejohej të parkojë XXX (XXX) taksi të tjera shtesë në Ambientet përballë Terminalit të Pasagjerëve për një vlerë shtesë prej XXX Euro pa TVSH.

40. Referuar Shtojcës nr. 2, të hartuar në XXX, palët kanë rënë dakord se duke filluar nga data XXX, AHA do t'i paguajë TIA-s tarifën mujore prej XXX Euro duke përfshirë TVSH dhe Tarifa Mujore do të jetë subjekt i rishikimit nga palët një herë në XXX vjet.
41. Në vijim të kërkesës për informacion të AK, mbi arsyet e ndryshimit të tarifës mujore nga XXX pa TVSH në XXX Euro me TVSH, ndërmarrja TIA nëpërmjet shkresës nr. 272/33 prot., datë 18.10.2023, dhe ndërmarrja AHA nëpërmjet shkresës nr. 272/28 prot., datë 26.09.2023, janë shprehur se, për shkak të parashikimeve të rritjes së numrit të pasagjerëve pranë aeroportit ndërkombëtar Nënë Tereza, është vlerësuar dhe pranuar rishikimi i tarifës mujore që AHA duhet ti pagojë TIA-s si pasojë e heqjes së kufizimit të numrit të vendeve të parkimit dhe rritjes së pritshme të numrit të pasagjerëve që duhet të udhëtojnë nëpërmjet aeroportit ndërkombëtar Nënë Tereza.

### **II.3.1 Masa e përkohshme**

42. Referuar sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, ndodhur përballë një situatë urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, për një shkelje të mundshme të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me Vendimin nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, vendosi:
  - I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si vijon:
    - a. Lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
    - b. Të heqë tabelën me shkrimin “Ndalohej taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të ligjit nr. 9121/2003.
  - II. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen e dijani të këtij vendimi.

- III. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
- IV. Në rast të moszbatimit të vendimit për masën e përkohshme të cituar në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b) të ligjit nr. 9121/2003.
43. Ky vendim ju njoftua ndërmarrjes TIA SHPK gjatë inspektimit të datës 31.05.2023 si dhe nëpërmjet shkresës nr. 272/13 prot., datë 24.05.2023 “Njoftim Vendimi”.
44. Grupi i Inspektimit ka kryer inspektime pranë zyrave qendrore të ndërmarrjes TIA SHPK në datat 22.05.2023, 31.05.2023 dhe 07.06.2023.
45. Gjatë inspektimit të datës 22.05.2023, nga ana e përfaqësueseve të ndërmarrjes TIA SHPK, pasi u vunë në dijeni për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës dhe shqetësimet e konkurrencës në këtë treg, u mor iniciativa për rishikimin e tabelës ndaluese në hyrje të zonës “Kiss and Fly”.
46. Ndërmarrja TIA, nëpërmjet shkresës nr. 272/14 prot., datë 29.05.2023 “Dërgim dokumentacioni në lidhje me inspektimin e datës 22.5.2023 dhe kthim përgjigje mbi shkresën nr. 2701/13 prot., datë 24.02.2023 “Njoftim Vendimi””, është shprehur se me largimin e grupit të inspektimit të AK, stafi i menaxhimit të aeroportit vendosi heqjen e tabelës përkatëse, ku sipas TIA u reflektua që në orët e para të mëngjesit të ditës vijuese. TIA bashkëlidhur kësaj shkrese ka bashkëngjitur dhe disa foto për të treguar edhe masat konkrete që janë marr për heqjen e tabelës “Ndalohet taksi pa pasagjerë”.
47. Në vijim të zbatimit të masës së përkohshme edhe pse pas depozitimit të fakteve nga ndërmarrja TIA SHPK ku tregohet se TIA ka zbatuar masën e përkohshme duke hequr tabelat përkatëse (sipas foto 1 dhe 2), grupi i inspektimit në datën 31.05.2023 u paraqit pranë aeroportit ndërkombëtar të Tiranës për të verifikuar në qoftë se tabela sipas shkresës së TIA-s ishte reflektuar. Grupi inspektimit evidentoi se në hyrjen e zonës “Kiss and Fly” pranë aeroportit të TIA, tabela me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, ishte hequr, në zbatim të pikës “b” të vendimit nr. 987, datë 24.05.2023.
48. Për të monitoruar zbatimin e pikës “a” të Vendimit nr. 987, datë 24.05.2023, me datë 07.06.2023, grupi i inspektimit u paraqit pranë zonës “Kiss and Fly” të TIA, nga ku u faktua me procesverbal që aksesit pa kushte ishte i lejueshëm për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

49. Gjatë hetimit të thelluar, grupi i inspektorëve u paraqit në datën 02.11.2023 pranë aeroportit TIA për monitorimin e zbatimit të masës së përkohshme. Nga kjo procedurë inspektimi rezultoi se në zonën 4 minutëshe, “Kiss&Fly”, lejohet aksesi i taksive pa pasagjerë, ky fakt vërtetohet edhe përmes procesverbaleve të monitorimit përkatës. Grupi i inspektimit evidentoi edhe se tabela me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk ishte afishuar më, në zbatim të plotë të pikës “b” të vendimit nr. 987, datë 24.05.2023.
50. Me shkresën nr. 50/10 prot., datë 30.04.2024, Ndërmarrja TIA ka sjellë në vëmendje se (a) tabela “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, ka qenë e vendosur shumë kohë përpara kalimit të 100% të kuotave të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës nga “Real Fortress Private Limited” në favor të ndërmarrjes “Kastrati Group”, dhe (b) nga hetimi nuk rezulton e provuar të këtë një autorizim të TIA-s për vendosjen e kësaj tablele.
51. **Sa më sipër, rezulton se ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ka zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 987, datë 24.05.2023 “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”.**

#### II.4 Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Auto Holiday Albania SHPK

52. Ndërmarrja Auto Holiday Albania SHPK, nëpërmjet kontratës së shërbimit, nënshkruar mes TIA-s, ka përfituar të drejtën e lejimit të ushtrimit të shërbimit taksi në terminalin e pasagjerëve të TIA-s<sup>3</sup>, për një periudhë nga XXX deri në XXX. Si rrjedhojë e kësaj kontrate, AHA ka të drejtën të përdorë në mënyrë të pakufizuar të ambienteve të TIA<sup>4</sup>.
53. Në faqen zyrtare të AHA, jepet mundësia për të rezervuar taksi si edhe janë të publikuara çmimet që aplikon ndërmarrja për transportin e udhëtarëve. Udhëtimi nga aeroporti drejt Tiranës kushton 20 deri në 28 Euro, ndërsa udhëtimet më të lira janë drejt Vorës dhe Fushë-Krujës me 14 Euro. Qytetet kryesore siç janë Durrësi, kanë një tarifë që varion nga 28 deri në 32 Euro, Kruja kushton 28 Euro, Vlora 103 Euro, Shkodra varion nga 65 në 74 Euro etj. Destinacion më i shtrenjtë është ai drejt qytetit të Delvinës, i cili kushton 205 Euro.
54. Nëpërmjet kontratës së shërbimit taksi të lidhur me ndërmarrjen AHA, e cila është e vetmja ndërmarrje që ofron shërbim taksi për pasagjerë nga Aeroportit ndërkombëtar i Tiranës drejt një destinacioni tjetër, tarifrat që kjo ndërmarrje aplikon për itinerarin TIA - Tiranë janë relativisht të larta me një tarifë prej 2500 lekë – 2900 lekë (20 –28 Euro) në krahasim me

---

<sup>3</sup> Neni 1.1 i kësaj kontrate

<sup>4</sup> Neni 5.1 i kësaj kontrate

ndërmarrjet e tjera që ofrojnë të njëjtin itinerar me tarifa që varjojnë nga 990 lekë – 1 300 lekë / 9.49 – 12.46 Euro).

55. Lidhur me tarifat e vendosura, ndërmarrja AHA shprehet se<sup>5</sup>, janë të pandryshuara që nga operatori paraardhës i licensuar për shërbimin taksi në TIA, për më tepër ndërmarrja AHA thekson se këto tarifa janë në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 3, datë 30.03.2009, i ndryshuar<sup>6</sup> dhe nr. 36 datë 04.04.2022<sup>7</sup>.
56. Këshilli Bashkiak me VKB nr. 3 datë 30.03.2009 “Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi në qytetin e Tiranës”, i ndryshuar, ka miratuar caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës. Caktimi i tarifave dhe çmimeve në shërbimin taksi, aktualisht përcaktohen sipas Vendimit nr. 36, datë 06.04.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 3 të Këshillit Bashkiak datë 30.03.2009”, sipas të cilit në datë 06.04.2022 është përcaktuar 300 Lekë si “tarifë fillestare” për 1.5 km e para.<sup>8</sup>
57. Referuar nenit 4.1 të kontratës së shërbimit “Për shërbimin taksi në Terminalin e Pasagjerëve të Tirana International Airport”, citohet se AHA duhet të jetë i pajisur me licensën përkatëse nga autoriteti shtetëror përkatës për aktivitetin e transportimit të pasagjerëve me shërbimin taksi duke filluar nga data e fillimit të kësaj Kontrate. Ndërmarrja AHA, sipas dokumentacionit të administruar është një subjekt i licensuar për ofrimin e shërbimit taksi nga Bashkia Krujë dhe realizon transport nga Aeroporti i Tiranës me destinacion vendndodhjen e kërkuar nga pasagjeri.
58. TIA nëpërmjet shkresës nr. 272/33 prot., datë 18.10.2023, është shprehur gjithashtu së është e hapur për ti dhënë akses në këtë shërbim kompanive të licensuara për ushtrimin e këtij shërbimi nga Bashkia Krujë, siç e parashikon Ligji, VKM dhe udhëzimi i Bashkisë Krujë për licencimin e shërbimit taksi edhe të kenë kualifikimin, eksperiencës në këtë fushë dhe të gëzojnë një reputacion të mirë në treg.
59. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 272/35 prot., datë 23.10.2023 drejtuar Bashkisë Krujë, i ka kërkuar informacionin nëse ka miratuar apo jo tarifa dhe çmime për shërbimin taksi për pasagjerë në territorin e saj. Bashkia Krujë me e-mailin e protokolluar pranë AK me nr. 272/36 prot., datë 25.10.2023, me objekt “Re: Kërkesë për informacion”, ku ka bashkëngjitur dokumentin, “VKB 2023 i skanuar.pdf”, ka rezultuar se ai nuk përmban

<sup>5</sup> Shkresa nr. 272/28 prot., datë 26.09.2023, dërguar nga Auto Holiday Albania SHPK

<sup>6</sup> [https://tirana.al/uploads/2019/5/20190515094538\\_14-taksite.pdf](https://tirana.al/uploads/2019/5/20190515094538_14-taksite.pdf)

<sup>7</sup> [https://tirana.al/uploads/2022/4/20220422101911\\_vendim-nr-36-dt-06042022-per-tarifate-taksive.doc](https://tirana.al/uploads/2022/4/20220422101911_vendim-nr-36-dt-06042022-per-tarifate-taksive.doc)

<sup>8</sup> Tarifa e përcaktuar në VKB nr. 3, datë 30.03.2009 e cila ka qenë në fuqi deri në datë 06.04.2022 ka qenë prej 250 lekë për 1.5 km.

informacionin e kërkuar mbi caktimin e tarifave dhe çmimeve në shërbimin taksi për Bashkinë Krujë.

60. Bashkia Krujë është një bashki relativisht e vogël dhe infrastruktura e transportit, veçanërisht ajo e transportit taksi, nuk është e zhvilluar në nivelin e përballimit të fluksit të rritur të udhëtarëve dhe turistëve. Kjo vihet re edhe në pohime e vetë ndërmarrjes TIA. Kjo ndërmarrje, në shkresën nr. 272/9 prot., datë 19.05.2023, TIA shprehet se “...Por si në momentin e lidhjes së kësaj kontrate, ashtu edhe në vijim, nuk është afruar asnjë subjekt tjetër që të plotësojë kriteret ligjore dhe teknike përveç rasteve që lejohen nga ligji...”. Pra TIA ka zgjedhur të vetmin operator në bashkinë Krujë që plotëson kriteret.
61. Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi Raportin Hetimor të Sekretariatit, procesverbalin e grupit të punës lidhur me zbatimin e masave të përkohshme si dhe prapësimet e ndërmarrjes të paraqitura gjatë seancës dëgjimore konstaton se:
- i. Tirana International Airport SHPK, ka zbatuar vendimin për masat e përkohshme duke rivendosur konkurrencën në tregun përkatës të produktit me heqjen e tabelës “*Ndalohet taksi pa pasagjerë*” dhe lejimin e aksesit të taksive të tjera. Gjatë procedurës hetimore administrative nuk u provua lidhja shkak pasojë, pra veprimi i TIA në vendosjen e tabelës dhe pasojave që kanë rrjedhur nga kjo sjellje (Konkluzion i grupit të punës në Raportin Hetimor, pika 116 fq.27, bashkëlidhur foto nr.4 nga *Google Map- Maj 2016*)<sup>9</sup>.
  - ii. Ka mospërputhje me tarifën e miratuara për shërbimin taksi për të saktësuar tregun gjeografik të shërbimit taksi nga/drejt aeroportit drejt/nga qyteti të Tiranës, pasi Auto Holiday Albania SHPK ndërkohë që është një ndërmarrje e licensuar nga Bashkia Krujë, përdor tarifën e miratuara nga Bashkia Tirane. Këto tarifa të cilat janë dhe të publikuara në faqen zyrtare të aeroportit TIA dhe të vetë AHA, janë fikse dhe jo në përputhje me bashkinë për të cilën është licensuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 5, pika 1 dhe nenin 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

---

<sup>9</sup> Sipas Raportit hetimor, #116 në faqen 27, “Grupi i Punës nuk arrin dot të përcaktojë dot nëse ndërmarrja TIA ka patur apo jo dijeni për tabelën përpara datës së inspektimit po as datën e saktë të vendosjes së kësaj table”. Si provë e pakundështueshme që mendojmë se duhet të merret parasysh nga Komisioni i Konkurrencës si organ kolegjal në funksion të një vendimi të bazuar në fakte dhe prova është foto e vendosur po nga Grupi i Punës i Autoritetit të Konkurrencës Foto nr. 4 – Regjistrimi i ekranit (print screen) nga Google Maps Street View në Aeroportin e Rinasit “Nënë Tereza”, maj 2016.



**VENDOSI:**

- I. Të mbyllë procedurën e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK dhe Auto Holiday Albania SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtare, nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
- II. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që, për shkak të rëndësisë që paraqet Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës (TIA), si dhe në kuadër të shtimit të numrit të aeroporteve të tjera ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, të rishikojë rregullimin e nenit 37 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” si dhe aktet e tjera nënligjore në bazë të tij, përta i përket detyrimit të nisjes së mjeteve pa pasagjerë jashtë bashkisë së licencimit, posaçërisht në lidhje me aeroportet ndërkombëtare.
- III. Tarifat për ndërmarrjen Auto Holiday Albania SHPK në zbatim të nenit 36 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të jenë në përputhje me tarifatat e aplikuara nga bashkia në të cilën është licensuar.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1084, Datë 10. 05. 2024**

**“MBI MONITORIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR. 921, DATË 09.11.2022 “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E MENAXHIMIT TË FACILITETEVE TË PARKIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) DHE MIRATIMIN E ANGAZHIMEVE SI TË DETYRUESHME NË FORMËN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE PËR NDËRMARRJEN STAR PARKING ALBANIA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10. 05. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK” .

**Bazë ligjore:** Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26, neni 74, pika 1, germa (c) dhe neni 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”;
- Shkresës së ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK nr. 173/2 prot., datë 08.03.2024 “Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të VKK nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e

procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”,

### VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022, Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen “Star Parking Albania” SHPK”, vendosi:
  - I. *Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” (Tirana International Airport).*
  - II. *Gjositjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,614,899 (një milion e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë.*
  - III. *Miratimin e angazhimeve të depozituar nga ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë vijon:*
    - a) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit;*
    - b) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër;*
    - c) *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.*
  - IV. *Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:*
    - a) *vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregimit;*
    - b) *kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;*
    - c) *zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;*
    - d) *vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.*

*V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltitetin përkatës.*

*VI. Për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të këtij vendimi, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK do të monitorohet për një periudhë 1 vjeçare.*

2. AK në vijim të monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të pikës III të dispozitivit të vendimit të VKK nr. 921/2022, nëpërmjet shkresës nr. 621 prot., datë 06.11.2023, ka kërkuar informacion ndaj ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK.
3. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, nëpërmjet shkresës së saj nr. 621/ prot, datë 22.11.2023 “Kthim përgjigje të shkresës nr. 621 prot., datë 06.11.2023 “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022”, ka depozituar informacionin mbi për periudhën 1 vjeçare të monitorimit.
4. Në datën 08.04.2024, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka realizuar seancën dëgjimore me ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK, në vijim të monitorimit të zbatimit të VKK nr. 921/2022.
5. Në vijim, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK me shkresën nr. 173/2 prot., datë 08.03.2024 “Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të VKK nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK”, ka depozituar pretendimet në formë shkresore.
6. Nga administrimi dhe përpunimi i informacionit për ndërmarrjen Star Parking Albania SHPK, konstatohet si më poshtë vijon:
  - i. *Lidhur me angazhimin e pikës III/a: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit.*
7. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nëpërmjet shkresës nr. 621/ prot, datë 22.11.2023 është shprehur se ka hartuar një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit për menaxhimin e faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza”.
8. Referuar shkresës nr. 173/2 prot., datë 08.03.2024, ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka

shprehur se: “...Sipas kërkesës së AK, në fund të vitit 2023, Star Parking Albania shpk ka dërguar një material përmbledhës të llogaritjes së përafërt të shpenzimeve operative dhe disa prej investimeve të kryera. Sjellim në vëmendjen tuaj se në këtë material, nuk janë përfshirë kostot e ndërtimit të godinës shumëkatëshe të parkimit (Multi-Storey) si dhe investimet për sistemet bashkëshoqëruese, të cilat i trajtuam në hyrje të kësaj shkrese. Star Parking shprehet se gjithashtu nuk rezultoi të këtë një referencë ligjore lidhur me mënyrën e llogaritjes së kostove të parkimit. Në këtë kuptim, Star Parking Albania do të vlerësonte ndihmën e AK në adresimin e kësaj çështjeje...”

9. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, pas mbylljes së hetimit si dhe gjatë periudhës së monitorimit nuk ka kërkuar ndihmën e AK për adresimin e problemit mbi mos pasjen e një referencë ligjore lidhur me mënyrën e llogaritjes së kostove të parkimit.
10. Pasja e një metodologjie për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit apo dhe shërbimeve të tjera është esenciale për ndërmarrje që gëzojnë një ekskluzivitet, ashtu si ndërmarrja Star Parking Albania SHPK, e cila është subjekti i vetëm që menaxhon facilitetet e parkimit, shërbimet dhe pajisjet e karrocave në Aeroportin “Nënë Tereza” (TIA). Kjo metodologji e formimit të çmimit është edhe me e nevojshme në momentin kur kjo ndërmarrje operon me norma fitimi mbi 40%.
11. Sa më sipër, lidhur me zbatimin e pikës III/a të VKK nr. 921/2022, rezultoi se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk ka hartuar një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepas-it.
  - ii. *Lidhur me angazhimin e pikës III/b: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër.*
12. Pavarësisht se ndërmarrja Star Parking është shprehur se, nuk ka aplikuar dhe nuk parashikon të aplikojë asnjë rritje të tarifave të telepaseve, duke i krahasuar këto tarifa me periudhën para marrjes së vendimit nga Komisioni i Konkurrencës, pra për periudhën janar - qershor 2021, detyrimi mujor për ndërmarrjet që operojnë në transportin e udhëtarëve (shërbimi autobus) nga TIA ka qenë 18,000 lekë/muaj për 1 telepas, ndërsa gjatë periudhës së monitorimit kjo tarifë ka qenë 36,000 lekë/copa për 1 telepas. Vihet re një rritje e çmimit të telepasit nga 18,000 lekë/copa në 36,000 lekë/copa.
13. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK gjithashtu nëpërmjet shkresës nr. 621/ prot, datë 22.11.2023, ka paraqitur dhe një tabelë me emërtimin “Analizë e çmimit për zona të ndryshme të parkimit”. Në përshkrimin e kësaj tablele gjenden: *Çmimi për telepas; Qira variabël për*

*TIA; Amortizimi i pajisjeve të parkimit; Shpenzimet direkte të punonjësve për pagat bruto dhe sigurimet për punonjësit e parkimit dhe supervisorët 9.1% e xhiros; Shpenzimet administrative për pagat bruto dhe sigurimet për administratën 1.5% mbi xhiron; Shpenzimet e mirëmbjjes dhe IT; Fitimi para tatimit; Fitimi bruto; Tatimi fitimit; Fitimi Neto. Pas vlerësimit të kësaj tabele është konkluduar se nuk përbën një analizë të çmimit për telepas.*

14. Sa më sipër, lidhur me zbatimin e pikës III/b të VKK nr. 921/2022, rezulton se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk zbaton tarifa të orientuara drejt kostos, ky fakt përforcohet edhe nga mos zbatimi i një metodologjie apo prej normave të fitimit mbi 40%.

iii. *Lidhur me angazhimin e pikës III/c: Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.*

15. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK lidhur me këtë pikë është shprehur se, siguron kushte të barabarta për të gjitha subjektet që janë pajisur me telepas si dhe për qytetarë të thjeshtë që janë përdorues të shërbimit të parkimit. Gjithashtu ka bashkëlidhur edhe disa kopje të kontratave të lidhura me ndërmarrje të ndryshme, por është evidentuar se ndërmarrja Star Parking nuk ka depozituar të gjitha kontratat për telepas, vihet re kjo nga mungesa e kontratave të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit të udhëtarëve nga TIA (shërbim autobus) të cilat kanë qenë dhe objekt i hetimit nga AK.

16. Nga kontratat e telepas lidhur me ndërmarrjet që kërkojnë shërbimin e telepas, vihet re:

- Tek kontratat e vitit 2023, Artikulli 3 që parashikon “*Star Parking ju ngarkon me një pagesë prej 6000 lekë (gjashtë mijë) në rast të humbjes apo prishjes së telepas-it si zhdëmtim të tij*”, nuk është i përcaktuar për të gjitha ndërmarrjet që kanë një kontratë telepas me Star Parking (vetëm për ndërmarrjet Global Fast Food Albania SHPK, A&A Aeroport SHPK dhe Air Albania SHPK).
- Tek kontrata e vitit 2023, në artikullin 2 që parashikohet “shuma e detyrimit për telepas”, Star Parking për ndërmarrjen Global Fast Food Albania SHPK ka përcaktuar “detyrimin për një telepas në vlerën 6000 lekë” dhe për ndërmarrjen Air Albania SHPK ka përcaktuar “detyrimin për një telepas në vlerën 180 000 lekë”, ndërsa për ndërmarrjen Mulliri i Vjetër SHPK ka përcaktuar “detyrimin 180 000 lekë për një telepas për një targë” dhe për ndërmarrjen Sombrero SHPK “detyrimin 180 000 lekë për një telepas për një targë”. Vihet re se, për ndërmarrjet e tjera artikulli 2 parashikon vetëm detyrimin për numrin e telepas të kërkuar pa përcaktuar kushtin e targës.
- Ndërmarrje të cilat janë kompani ajrore si psh. Alba Wings në 2022, për një kohëzgjatje 1 vit, për 1 telepas ka paguar vlerën 72,000 lekë dhe detyrimi total 72,000 lekë, ndërsa ndërmarrja Air Albania në vitin 2023 për një kohëzgjatje 1 vit, për 2 telepas në vlerën

180,000 lekë, detyrimin total 360,000 lekë.

17. Sa më sipër, lidhur me zbatimin e pikës III/c të VKK nr. 921/2022, rezulton se ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka zbatuar kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me Star Parking për tu pajisur me telepas dhe nuk ka paraqitur arsye për këtë trajtim të ndryshëm.
18. Ndërmarrja Star Parking Albania SHPK ka pozitë dominuese prej 100% në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit pranë TIA. Bazuar në praktikat më të mira të Komisionit Evropian dhe të OECD, monopoli krijon mundësi potenciale për abuzim të pozitës dominuese në tregun përkatës.
19. Referuar nenit 9, pika 1 dhe 2, germa a, të ligjit nr. 9121/2003, përcaktohet qartë se vendosja e çmimeve të padrejta apo kushteve të tjera të padrejta të tregtimit përbën shkelje të këtij neni, duke abuzuar me pozitën dominuese në treg. Termit “çmime të padrejta” i është referuar Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe Komisioni Evropian, në rastin e çmimeve ekseseve<sup>10</sup> (diferenca ekseseve midis kostos totale të produktit dhe çmimit përfundimtar të shitjes). Referuar rasteve të trajtuara nga Komisioni Evropian dhe Gjykata Europiane e Drejtësisë, çmim eksesev është çmimi që nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit<sup>11</sup>.
20. Një nga karakteristikat e përbashkëta të të gjitha rasteve të gjykuara nga ana e Komisionit Evropian është përdorimi i metodologjisë krahasuese, të produkteve apo shërbimeve në tregun e përbashkët evropian. Në rastin e United Brands, Gjykata Europiane e Drejtësisë ka përcaktuar qartë se mungesa e lidhjes së çmimit të produktit me vlerën ekonomike të arsyeshme të tij, bën që çmimi i produktit të vlerësohet si një çmim i padrejtë. Kanë qenë dy treguesit kumulativë që janë përdorur kryesisht nga ana e Gjykatës së Drejtësisë në Rastin e United Brands. (1) Fillimisht krahasimi i kostos totale të produktit me çmimin përfundimtar të shitjes është ekseseve (e padrejtë). (2) Përcaktimi nëse çmimi i shitjes së produktit në këtë rast është i padrejtë në vetvete apo ky çmim gjithashtu është i padrejtë edhe nëse krahasohet me produkte të ngjashme, pra ai është eksesev nëse krahasohet me produkte të ngjashme.

---

<sup>10</sup> Shiko Psh, Sirena vs. Eda [1971] ECR 69, according to Gal (2004:358) the first case where monopolistic prices without harm to competition were found abusive; Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207 (on this case see also Annex 4); Case 30/87 Corinne Bodson vs. Pompes Funebres [1998] ECR 2479; Case 110/99 Lucazeau vs. Sacem [1989] ECR 2811 and Commission Decisions COMP/C-1/36915 British Post office vs. Deutsche Post AG [2001] OJ L331/40; COMP/A36568/D3 Scandlines Sverige AB vs. Port of Helsingborg and Sundbusserne AS vs. Port of Helsingborg [Jul 23, 2004]

<sup>11</sup> Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207, paragrafi 250: “ In this case charging a price which is excessive because it has no reasonable relation to the economic value of the product supplied would be such an abuse”.

21. Bazuar në rastin e Komisionit Evropian<sup>12</sup> është e këshillueshme që të konstatohet nëse ndërmarrja me pozitë dominuese ka shfrytëzuar mundësitë që lindin nga pozicioni i saj dominues për të marrë përfitime tregtare, të cilat nuk do të kishte mundësi t'i përfitonte në kushtet e një tregu më konkurrues.

Në këtë rast vendosja e një çmimi që është eksziv (i tepruar/i lartë), sepse nuk ka lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit të ofruar do të konsiderohet abuzim.

Kjo diferencë, ndër të tjera, mund të përcaktohet objektivisht nëse do të ishte e mundur të llogaritet duke bërë një krahasim ndërmjet çmimit të shitjes së produktit dhe kostos së tij të prodhimit, të cilat do të përcaktonin marzhin e fitimit<sup>13</sup>;

Prandaj, ajo që duhet përcaktuar është nëse ndryshimi ndërmjet çmimit të produktit dhe kostove të prodhimit të tij është i tepruar dhe nëse çmimi i vendosur është i padrejtë në vetvete ose kur krahasohet me produkte konkurruese.

Gjithashtu duhen vlerësuar vështirësitë e konsiderueshme në përpunimin e kostove të prodhimit, të cilat ndonjëherë mund të përfshijnë një pjesë të kostove indirekte dhe shpenzimeve të përgjithshme dhe të cilat mund variojnë ndjeshëm sipas madhësisë së ndërmarrjes, objektit të saj, natyrës komplekse të krijimit të saj, zonës së saj territoriale të operimit, pavarësisht nëse ajo prodhon një ose disa produkte, numrin e filialeve të saj dhe marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin.

22. Kur ndërmarrjet nuk përmbushin kushtet dhe detyrimet në mbështetje të një vendimi të marrë, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 74, pika 1, germa (c) dhe nenin 75 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

- I. Vijimin e monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën III të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Aeroportit “Nënë Tereza” dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen “Star Parking Albania SHPK”, edhe për një periudhë 1 vjeçare.

<sup>12</sup> Burimi: Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207, paragrafët 249-254.

<sup>13</sup> Burimi: Case 27/76 United Brands vs. Commission [1978] ECR 207, paragrafi 251 “...megjithatë Komisioni nuk e ka bërë këtë pasi nuk ka analizuar strukturën e kostove të UBC-së.”



II. Gjobitjen e ndërmarrjes Star Parking Albania SHPK, për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën III të VKK nr. 921/2022, në masën 756,581 Lekë (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) Lekë.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1085, Datë 14. 06 .2024**

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NE QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER DHE KORCË”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 06 .2024 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e hetimit paraparak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

1. Raportit mbi monitorimin e tregut të grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, dhe;
2. Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e tregut të grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve”,

**VËREN SE:**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nga muaji shkurt 2024 e në vijim ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve për analizimin e kushteve të këtij tregu.
3. Në vazhdim të procedurës, me qëllim mbledhjen e të dhënave dhe fakteve të nevojshme lidhur me monitorimin e këtij tregu, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e

konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë. Gjithashtu janë marrë në analizë raporte dhe studime të ndryshme nga eksperiencia europiane.

4. Gjatë kësaj procedure janë realizuar monitorime në ambientet e tregjeve të grumbullimit dhe shitjes me shumicë në: Tiranë, Elbasan, Divjakë, Durrës, Fier, Berat dhe Korçë, për të vlerësuar zinxhirin e tregtimit nga fermerët deri tek konsumatori përfundimtar me qëllim evidentimin e çmimeve të blerjes dhe të shitjes me shumicë nga ana e grumbulluesve të perimeve si: qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, karrota dhe specat; dhe frutave si: mollë, portokalle, limona, luleshtrydhe dhe dardha.
5. Gjithashtu më datë 19.02.2024, u realizua takim me fermerët e zonës së Klos, Mollas, Jagodinë në rrethin e Elbasanit; më datë 27.02.2024, u realizua takim me fermerët e zonës së Roskovecit; si dhe më datë 23.05.2024 u realizua takim me fermerët e zonës së Samaticës, Dimal, Berat.
6. Nga vlerësimi i bazës ligjore dhe eksperiencës europiane, vërehet se për tregun e prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve ka mungesa ligjore të akteve të BE për mirëfunksionimin e të gjitha niveleve të tregut.
7. Perimet përbëjnë një nga nën sektorët më produktivë dhe të rëndësishëm të bujqësisë Shqiptare, me mundësi të mira të rritjes së tregut të brendshëm dhe atij për eksport. Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2022, rezulton se qarqet më të mëdha për prodhimin e perimeve në serra janë qarku i Fierit, Beratit dhe Tiranës, ndërsa për prodhimin e frutave janë qarku i Korçës dhe Elbasanit. Këto janë qytetet të cilat kanë peshën më të madhe të prodhimit në vendin tonë.
8. Nga struktura e tregut konstatohet se ky treg ka shumë nivele tregtimi: Fermerët/prodhuesit; Importuesit dhe eksportuesit e frutave dhe perimeve; Pikat e grumbullimit; Shitësit me shumicë (Tregjet Agroushqimore me Shumicë); Shitësit me pakicë.
9. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vërehet se qarku me i madh për nga numri grumbulluesve dhe për nga xhiro për vitin 2022 është qarku i Fierit me 53.5% të totalit të xhiros së realizuar në të gjithë Shqipërinë, e ndjekur nga qarku i Tiranës me 24% dhe qarku i Beratit me rreth 10%. Në këto të dhëna janë paraqitur edhe grumbulluesit të cilët realizojnë importe dhe eksporte.
10. Bazuar në të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, janë identifikuar ndërmarrjet importuese dhe eksportuese, por janë marrë në analizë vetëm ndërmarrjet të cilat kanë një pjesë mbi 5% në raport me sasinë totale të importuar dhe eksportuar të fruta perimeve për periudhën janar 2023 – shkurt 2024:

- Ndërmarrjet me pjesë më të madhe sipas sasisë së importuar të perimeve janë XXX shpk me XX%, XXX sha me XX%, XXX shpk me XX% etj. Vendet kryesore të importit të perimeve janë Greqia, Kosova, Turqia, Serbia, Gjermania, etj. Vlen të theksohet se për periudhën nën monitorim janë 116 ndërmarrje importuese në total.
- Ndërmarrje eksportuese për perimet në total nga të cilat XXX shpk me XX%, XXX shpk me XX%, XXX shpk me XX% dhe 101 ndërmarrje të tjera me pjesë më të vogël se 0.1-4%.
- Ndërmarrjet me pjesë më të madhe sipas sasisë së importuar të frutave janë XXX shpk me XX%, XXXshpk me XX%, XXX shpk me XX%, XXX shpk me XX% etj. Vendet kryesore të importit të frutave janë Greqia, Italia, Serbia, Turqia etj. Vlen të theksohet se për periudhën nën monitorim janë 94 ndërmarrje importuese në total.
- Për periudhën nën monitorim janë 84 ndërmarrje eksportuese për frutat në total nga të cilat XXX me XX%, XXX me XX%, XXX shpk me XX%, XXX shpk me XX% dhe 80 ndërmarrje të tjera me pjesë më të vogël se 0.1-4%.

11. Nga monitorimi i tregut të grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve vërehet re se:

- Në qarkun e **Tiranës** operojnë 18 ndërmarrje me një xhiro totale prej 4,494,352,131 lekë. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe të xhiros në raport me xhiron totale të realizuar në vitin 2022 për këtë qark paraqiten: XXX me XX %, XXX shpk me XX% dhe XXX shpk me XX %. Ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë më të vogël se 7.7 % në raport të xhiros totale të realizuar për këtë qark;
- Nga monitorimi në terren në këtë qark vihet re se nga çmimet e blerjes te fermeri nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese, deri te çmimet e shitjes me shumicë të vendosura nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese kemi një diferencë prej 11 – 55 % për produkte të ndryshme fruta-perime. Ndërsa diferenca nga çmimet me shumicë të aplikuara nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese me çmimet e shitjes me pakicë, rezulton nga 27 – 100 %.
- Në qarkun e **Fierit** operojnë 41 ndërmarrje me një xhiro totale prej 9,939,341,789 lekë. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe të xhiros në raport me xhiron totale të realizuar në vitin 2022 për këtë qark paraqiten: XXX shpk me XX %, XXXshpk me XX%, XXX me XX% dhe XXX shpk me XX %. Ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë më të vogël se 5.5 % në raport të xhiros totale të realizuar për këtë qark.
- Nga monitorimi në terren në këtë qark, vihet re se nga çmimet e blerjes te fermeri nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese, deri te çmimet e shitjes me shumicë të vendosura nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese kemi një diferencë prej 11 – 50 % për produkte të ndryshme fruta-perime.
- Në qarkun e **Beratit** operojnë 8 ndërmarrje me një xhiro totale prej 1,932,775,704 lekë. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe të xhiros në raport me xhiron totale të realizuar në vitin 2022 për këtë qark paraqiten: XXX shpk me XX %, XXX shpk me XX %, XXX shpk

me XX% dhe XXX shpk me XX %. Ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë më të vogël se 7 % në raport të xhiros totale të realizuar për këtë qark.

- Gjatë takimit të realizuar me fermerët në qarkun e Beratit nga ana e tyre është pretenduar se:
  - a) Çmimet e produkteve bujqësore (fruta dhe perime) janë të padrejta dhe krijimi i një burse për çmimet e prodhimeve bujqësore do të parandalonte spekulimet me çmimet.
  - b) Pikat grumbulluese në shumicën e rasteve mbledhin produktin e fermerëve pa një cmim dhe nuk lëshojnë fature TVSH-je, dhe si pasoje kjo sjell pasoja për fermerin, sepse fermeri nuk njihet me cmimin real që produkti shitet në tregun vendas ose me cmimin me të cilin ky produkt është shitur në eksport. Fermerët paraqitën ankesa të ndryshme ku problematika kryesore qëndronte në fiksimin e cmimit të blerjes së produkteve nga ana e të gjitha pikave grumbulluese të zonës.
  - c) Faturat që deklarohen në bilancet e tyre pikat grumbulluese janë fiktive dhe nuk paraqesin cmimin real, e cila sipas fermerëve bëhet me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.
  - d) Pikat e grumbullimit operojnë pa kontratë me fermerët, duke i ekspozuar këta të fundit përballë rreziqeve, që një produkt bujqësor ta shesin me humbje. Sipas fermerëve kjo mënyrë pune nga ana e grumbulluesve ku punohet pa kontratë, pa çmime dhe në shumë raste edhe pa faturë, e ka deformuar tregun, duke sjellë çmime abuzive.
- Në qarkun e **Elbasanit**, ku rezulton se operojnë 3 ndërmarrje me një xhiro totale prej 55,333,943 lekë. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe të xhiros në raport me xhiron totale të realizuar në vitin 2022 për këtë qark paraqiten: XXX me XX %, XXX shpk me XX % dhe XXX me XX %;
- Nga monitorimi në terren në këtë qark, vihet re se çmimet e blerjes të fermeri nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese, deri të çmimet e shitjes me shumicë të vendosura nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese kemi një diferencë prej 7 – 56 % për produkte të ndryshme fruta-perime.
- Në qarkun e **Korçës**, ku rezulton se operojnë 16 ndërmarrje me një xhiro totale prej 676,963,750 lekë. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe të xhiros në raport me xhiron totale të realizuar në vitin 2022 për këtë qark paraqiten: XXX me XX %, XXX shpk me XX % dhe XXX me XX %. Ndërmarrjet e tjera kanë një pjesë më të vogël se 8.5 % në raport të xhiros totale të realizuar për këtë qark;
- Nga monitorimi në terren në këtë qark vihet re se nga çmimet e blerjes të fermeri nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese, deri të çmimet e shitjes me shumicë të vendosura nga ana e ndërmarrjeve grumbulluese kemi një diferencë prej 17 – 40 % për produkte të ndryshme fruta-perime.

12. Tregu i grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, ndër të tjera ka problematika sa i përket: ekonomisë informale dhe integritit vertikal pasi grumbulluesit mund të zotërojnë

edhe vetë sera. Duke qenë se tregu i prodhimit, grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve është i përbërë nga shumë nivele tregtimi, çmimet nga fermeri te konsumatori përfundimtar rezultojnë shumë të larta për konsumatorin fundor (marzhe deri në 50% në qarqet e monitoruara) megjithëse çmimi final i produkteve në tregun e pakicës ndikohet nga *frot* (humbjet) dhe jetëgjatësia e produktit në raft.

13. Sa më sipër, referuar strukturës së tregut, integritit vertikal, sjelljes së ndërmarrjeve grumbulluese dhe diferencave të mëdha në zinxhirin e vlerës së produktit nga prodhuesit, grumbulluesit, shitësit me shumicë deri tek konsumatori fundor, mund të jemi para një sjelljeje antikonkurrese si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24 shkronja (d), neni 26, dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve, për të parë nëse ka, ose jo, shkelje të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 31 Maj 2024.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1087 Datë 14.06.2024**

**“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ NDËRMARRJES ARLIS ADMINISTRIM SHPK PËR REFUZIMIN E PRANIMIT TË INSPEKTIMEVE NË MBËSHTETJE TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 06. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për refuzimin e pranimit të inspektimeve në mbështetje të vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

**Bazë ligjore:** Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

**VËREN SE:**

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, për periudhën kohore nga 1 janar 2020 deri në 10 maj 2024.
2. Gjatë procedurave hetimore është konstatuar se sjellja e ndërmarrjes Arlis SHPK në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese, duke refuzuar aksesin ndërmarrjeve të tjera që ofrojnë shërbimin e internetit në rezidencat e banimit ku kjo ndërmarrje operon.

3. Në mbështetje të nenit 35 të ligjit nr. 9121, datë 28.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1078, datë 10.05.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit që këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë”, si edhe autorizimit të inspektimit nr. 23/55, datë 20.05.2024, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës në datën 23.05.2024 u paraqitën në adresën e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK, Rruga “Muhedin Llagani”, Pallati Vala, kati 1, nr.7, Tiranë, për të realizuar inspektimin pranë kësaj ndërmarrje.
4. Gjatë inspektimit në ndërmarrjen Arlis Administrim SHPK, inspektorët e Sekretariatit autorizuar me shkrim nga Komisioni për kryerjen e inspektimeve, u refuzuan për dhënien e çdo lloj informacioni që lidhet me objektin dhe qëllimin e inspektimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 36, germa (b), (c), (ç) dhe (d) e ligjit nr. 9121/2003.
5. Në zbatim të nenit 35, pika 2 e ligjit nr. 9121/2003 punonjësve të ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK ju vu në dispozicion autorizimi nr. 23/55, datë 20.05.2024, i cili përmban objektin dhe qëllimin e inspektimit, si dhe u vunë në dijeni për sanksionet e parashikuara në nenin 73, pika 1 germa (c) dhe (ç) të këtij ligji.
6. Kur ndërmarrjet refuzojnë të pranojnë inspektimet në mbështetje të vendimit të marrë, ose refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve për faktet, ose pengojnë inspektimin, në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, nenin 26 dhe nenin 73, pika 1, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Gjorbitjen e ndërmarrjes Arlis Administrim SHPK për shkelje të lehtë të konkurrencës, konkretisht të nenit 73, germa (c) dhe (ç) të ligjit nr. 9121/2003 në masën 48,392 (dyzetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) Lekë
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1088, Datë 21. 06. 2024**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË DREJTPËRDREJTË TË SHOQËRISË ANCALA TOPCO LIMITED DHE INDIREKT PËRFTIMIT TË 50% TË KAPITALIT AKSIONAR TË SHOQËRISË DRAGON LNG LIMITED, NGA SHOQËRIA VTTI ENERGY UK LTD.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	FatjolaDelija	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 06. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:**

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfutimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

**Baza Ligjore:**

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfutimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfutimit të kontrollit

të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfundimisht të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë 19 prill 2024, palët në marrëveshje janë:

**Blerësi: VTTI ENERGY UK LTD** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Uellsit, me objekt aktiviteti: Aktivitete të tjera të shërbimit mbështetës të biznesit të pa klasifikuara diku tjetër.

**Garantuesi: VTTI B.V.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës dhe me aksionar të vetëm shoqërinë VTTI Finance B.V.. Shoqëria zotëron, administron, operon dhe zhvillon asetë të infrastrukturës energjetike në nivel ndërkombëtar me fokus në sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Ajo ka si aktivitet kryesor zotërimin dhe operimin e terminaleve të magazinimit të energjisë për produktet e naftës, kimikatet dhe vegoil në portet dhe limanet në mbarë botën, por pa aktivitete, prani apo të ardhura në Shqipëri.

VTTI zotërohet në mënyrë indirekte nga VTTI Holding B.V., shoqëri e cila kontrollohet bashkërisht nga Vitol Holding II S.A. dhe IFM Global Infrastructure Fund.

[.....].

**Shitësi: Ancala (SCOT) LP** është një shoqëri aksionare e regjistruar, sipas legjislacionit të Anglisë.

**Shoqëria Target: Ancala Topco Limited** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit të Anglisë dhe Uellsit, me objekt aktiviteti: Mbajtjen e investimeve.

Ancala Topco Limited, zotëron 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Ancala LNG Holdco Ltd, e cila zotëron 100% të kapitalit aksionar të Ancala LNG Midco Ltd, dhe kjo e fundit zotëron 100% të kapitalit aksionar të Ancala LNG Ltd e cila zotëron 50% të të gjithë kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë Dragon LNG Group Ltd.

**Dragon LNG Group Ltd** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Uellsit. Dragon LNG Group Ltd ofron shërbime të rigazifikimit të LNG (përfshirë ngarkimin, ruajtjen, fleksibilitetin, matjen dhe shërbimet detare).

Dragon LNG Group Ltd zotëron dy filiale. Filiali kryesor **Dragon LNG Limited** operon gazin natyror të lëngshëm Dragon i vendosur në Milford Haven, Uells, Mbretëria e Bashkuar. Filiali tjetër **Dragon Energy Ltd** operon një vend gjenerimi diellor i cili kryesisht siguron nevojat me energji elektrike të terminalit Dragon LNG, por gjithashtu gjeneron shitje *de minimis* palëve të treta.

Dragon LNG Group Ltd dhe filialet e tij janë aktive vetëm në Mbretërinë e Bashkuar nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

## II. Transaksioni

Më datë 19 prill 2024 ndërmjet shoqërisë Ancala (SCOT) LP (Shitësi), shoqërisë VTTI ENERGY UK LTD (Blerësi) dhe VTTI B.V. (Garantuesi), është nënshkruar “Marrëveshje për blerjen e aksioneve”, lidhur me shitjen dhe blerjen 100% të kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë Ancala Topco Limited.

Referuar kësaj marrëveshje, neni 2 “Shitja e Aksioneve” parashikon se shitësi do të shesë (dhe blerësi do të blejë) Aksionet sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje, me garanci të plotë të titullit.

Referuar deklarimeve të palës njoftuese në Formularin e thjeshtë të njoftimit, shoqëria VTTI ENERGY UK LTD, ka rënë dakord të blejë indirekt 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë, Dragon LNG Group Ltd, nëpërmjet blerjes së drejtpërdrejtë (100%) të shoqërisë Ancala Topco Limited.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfitim të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i rigazifikimit të LNG përfshirë ngarkimin, ruajtjen, fleksibilitetin, matjen dhe shërbimet detare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përfitim të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.

VTTI ENERGY UK LTD është një shoqëri angleze, e zotëruar plotësisht nga shoqëria VTTI B.V. Aktiviteti i saj kryesor është zotërimi dhe operimi i terminaleve të magazinimit të energjisë për produktet e naftës, por pa aktivitete, prani apo të ardhura në Shqipëri.

[.....].

Dragon LNG Group nuk ka prezencë dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga sa më sipër, Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Ancala Topco Limited dhe indirekt përftimit të 50% të kapitalit aksionar të shoqërisë Dragon LNG Limited, nga shoqëria VTTI ENERGY UK LTD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1089, Datë 21. 06. 2024**

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE ADASTRA SHPK DHE COLOMBO SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 06. 2024, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Hapja e procedurës së hetimit paraparak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.

**Bazë ligjore:** Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

**VËREN SE:**

1. Agjencia e Prokurimeve Publike (APP) nëpërmjet shkresës nr. 3321/1 prot., datë 27.05.2024, (protokolluar pranë AK me nr. 388 prot., datë 28.05.2024), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës, një rast mbi dyshimin për marrëveshjeje në oferta midis operatorëve ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit.
2. APP nëpërmjet kësaj shkrese shprehet se është depozituar shkresa nr. 2640/8 prot., datë 26.04.2024 (protokolluar në APP me nr. 3321 prot., datë 30.04.2024) më lëndë: “Kërkesë për

përjashtim OE nga procedurat e prokurimit publik”, e Qendrës së Personel Rekrutimit, e cila ka kërkuar vlerësimin e rastit për operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK.

3. Operatorët ekonomik Colombo SHPK dhe Adastra SHPK kanë qenë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, në datën 15.04.2024.
4. Sipas Autoritetit Kontraktor është konstatuar se të dy operatorët ekonomik të sipërcituar kanë lidhje familjare pasi administratorët e këtyre shoqërive janë në rrethin e personave të lidhur me njëri tjetrin (bashkëshortë) si dhe operatori ekonomik Colombo SHPK ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.
5. APP, i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë të Ligjit nr. 162/2020 “për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 parashikohet se qëllimi i këtij ligji është si më poshtë vijon:
  - a) Të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
  - b) Të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
  - c) Të nxisë pjesëmarrjen e operatoreve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
  - d) Të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
  - e) Të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.
  - f) Të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.
6. APP shprehet se, referuar dokumentacionit të dërguar në AK, “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur” nga operatori ekonomik Adastra SHPK është dërguar e paplotë dhe e panëshkruar nga subjekti dhe pas renditjes së tij në vendin e parë (mundon faqe e dytë e tij). Qëllimi i plotësimit të kësaj deklaratë është ndalimi i marrëveshjeve të fshehta ne ofertë, pasi ky veprim çon në pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbëjnë shkelje të rendë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
7. Nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës, ndërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019, të nënshkruar më Autoritetin e Konkurrencës, APP përcjell këtë rast për të vijuar më tej hetimin sa i takon kësaj çështjeje.
8. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga APP, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK, dhe informacionit të Qendrës së Personel Rekrutimit, mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për

funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë, vihet re:

- Ndërmarrja Adastra SHPK ka paraqitur “Deklaratë për paraqitje oferte e pavarur”, të plotë dhe të nënshkruar.
- Autorizim i datës 24.04.2024, ku ndërmarrja Adastra SHPK autorizon Z. Petrit Levendi të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor “Reparti Ushtarak nr. 6670 Qendra e Personel Rekrutimit Tiranë”, për të dorëzuar dokumentat dhe mostrat për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”.
- Z. Petrit Levendi është administrator dhe ortak i vetëm ndërmarrjes Colombo SHPK, gjithashtu pjesëmarrës në procedurën e prokurimit me objekt: “Shpenzime për materiale për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.
- Ndërmarrja Adastra SHPK dhe ndërmarrja Colombo SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
- Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Adastra SHPK gjendet, vërtetim debie i datës 03.04.2024 “Për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, për personat juridik të interesuar për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura, si dhe për personat fizikë dhe juridikë të interesuar për procedurat që lidhen me zbatimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit lidhur me ndërtimet e reja”, vërtetim i lëshuar me kërkesën e ndërmarrjes Colombo SHPK.

9. Sa më sipër ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Adastra SHPK dhe Colombo SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sinqertë.

10. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, kjo sjellje hedh dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit.

11. Për sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit me objekt “Shpenzime për material për funksionimin e paisjeve të zyrës”, të zhvilluar nga Qendra e Personel Rekrutimit, ka elementë të një sjelljeje



antikonkurruese, e cila mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

- III. Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Adastra SHPK dhe Colombo SHPK.
- IV. Hetimi paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2022 deri në 21.06.2024
- V. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2024**  
BULETINI ZYRTAR



2024